

PËRMBAJTJA

Lajme 2

Milazim Krasniqi: Bizantinofilia kërkon vendlindje në Kosovë 3

Gëzim Qerimi: Hapen dyert e konvikteve për 3073 studentë 4-5

Intervistë me Talip Aktash..... 6-8

Osman D. Gashi: Rritet qarkullimi, rriten çmimet ... 9

Sabri Halili: Sfidimi në matematikë dhe kundërshtimet ndjellakeqe 10-12

Avni Avdiu: Ngritja dhe rënia e PDSH-së 12-13

Fitim Veliu: Viti i ri shkollor me probleme të vjetra... 14

Vjollca Sheqiri: Kosova me shifra shqetësuese të alfabetizimit 15

Arber Zeka: "RAHMA MERCY" ndihmon 550 fëmijë jetimë të Skenderajt..... 16

Florije Ademi: Shembull se si mund të bashkëjetohej. 17-18

Emine A. Vezaj: "Tregtarët" e fesë-të konvertuarit... 18-19

Demir Reshiti: Tri njohje gjatë muajit gusht 20-21

Muhamed Jusufi-Kajolli: Të dërguam për mbarë njerëzimin 22-23

Debat mbi Islamofobinë në Perëndim..... 24-25

Nijazi Ramadani: Mustafë Kokaj, mësuesi që nuk pajtohej me robërinë..... 26-27

Fatos Shala: Edhe fëmijët konsumues të pluhurit të bardhë 28

Sadat Musa: Jasir Krasniqi, hafizi më i ri i Republikës së Kosovës..... 29

Mimoza Sinani: Bumerang (tregim) 30-31

Flamur Maloku: Vetmia me tekstin 32-33

Poezi 34

Berat Dakaj: P(r)oetika dramatike 35

Naser Shatrolli: Dimensione të reja teatrore..... 36

Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Kontracepsioni emergjent 37-38

Ditëlind Reshiti: Këshilla praktike 39

Fjalëkryqi 40



6 Intervistë me Talip Aktash



9 Rritet qarkullimi...



15 Kosova me shifra shqetësuese...



26 Mësuesi që nuk pajtohej me...



29 Jasir Krasniqi hafizi më i ri...



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 22

19 shtator - 19 tetor 2008

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Demir RESHITI

demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmalko@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Prishtinë

30 korrik 2008

Filloi dhënia e pasaportave të para të Republikës së Kosovës

Kryeministri Hashim Thaçi i ka dorëzuar pasaportën e parë të Republikës së Kosovës qytetares Teuta Begolli. Në ceremoninë solemne të dhënies së pasaportave të para të shtetit të Kosovës, që u zhvillua në objektet e Komunes së Prishtinës, ishin të pranishëm zëvendëskryeministrat Hajredin Kuçi e Ramë Manaj dhe ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti.



Prishtinë

28 gusht 2008

Publikohen emrat e 10 të ngarkuarve me punë në ambasadat e para të Republikës së Kosovës

Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, ka publikuar emrat e 10 të ngarkuarve të parë në ambasadat e Republikës së Kosovës në botë. **Avni Spahiu**, do të jetë i ngarkuar me punë në Uashington, ndërsa **Sylejman Gashi** në Nju-Jork, **Muhamedin Kullashi** në Paris, **Ilir Dugolli** në Bruksel, **Muhamet Hamiti** në Londër, **Vilson Mirëdita** në Berlin, **Albert Prengaj** në Romë, **Sabri Këçmari** në Vjenë, **Naim Mala** në Bernë, **Gazmend Pula** në Tiranë dhe **Bekim Sejdiu** në Ankara.



Prishtinë

29 gusht 2008

Gjenerali italian Giuseppe Emilio Gay komandant i ri i KFOR-it

Gjenerali italian Giuseppe Emilio Gay ka marrë komandën e forcave paqeruajtëse në Kosovë.

Transferimi i komandës nga gjenerali i deritashëm Ksavie de Marnak u bë në një ceremoni ku morën pjesë përfaqësues të lartë të NATO-s dhe të institucioneve të Kosovës. Gjenerali Gay është komandanti i 13-të me radhë që do të udhëheqë 16 mijë pjesëtarë të KFOR-it.



Tiranë

11 shtator 2008

Shqipëria e para në grupin 1

Shqipëria me golat Bogdanit, Duros dhe Dallkut, ka mposhtur Maltën dhe është radhitur e para në Grupin e parë të eliminatorëve për kampionatin botëror 2010 në futboll.

Kuqezinjtë janë në krye të grupit me katër pikë, pas barazimit në xhiron e parë me Suedinë. Në vend të dytë po me katër pikë, por me golaverazh më të dobët janë Danimarka dhe Suedia. Portugezet janë në vend të katërt me tre pikë ndërsa vendin e pestë e mban Hungaria me një pikë. Në fund të tabelës është Malta pa asnjë pikë. Më 11 tetor, Shqipëria luan ndeshjen e tretë si mysafire e Hungarisë ndërsa në ndeshjet tjera takohen Suedia me Portugalinë dhe Danimarka me Maltën.



Bizantinofilia kërkon vendlindje në Kosovë



Milazim KRASNIQI

Ideve dhe iniciativave absurde që dinë të jenë prezente jo rrallë në jetën kulturore e publike të shqiptarëve, këto ditë iu shtua edhe një: ideja për shqiptarizimin e perandorit bizantin, Justinianit. E gjetur nga një shoqatë që mbaka emrin “Anton Pashku” dhe një tjetër “Gollaku”, kjo ide tashmë është shndërruar në një projekt kulturoro-politik, që kërkon me ngulm edhe ndihmën e komunës së Podujevës e edhe të qeverisë së Kosovës, që me një yrrysh ta “justinianizojë”, pra, ta bizantinizojë sa më shumë Kosovën, thua se ka pak bizantinizëm në jetën politike të saj.

Organizatorët e aktivitetit kulturoropolitik, “Gjurmëve të perandorit Justinian”, kanë kërkuar madje edhe emërtimin e Liqenit të Batllavës me emrin e perandorit bizantin! Nëse kjo miratohet, atëherë shqiptarët do të pinin ujë të jodiuar me emrin dhe me bëmat e njërit nga simbolet më të mëdha të bizantinizimit. Vërtet, kjo ide është skajshmërisht absurde, sepse me emrin e Justinianit më parë do të duhej të emërtohej ndonjë thertore, ku gjaku shkon valë-valë, si në hipodromet e Bizantit kur Justiniani ishte perandor, e kurrsesi një liqen

me ujë të pastër. Organizatorët pohojnë se kanë kërkuar që edhe një shkollë të mbajë emrin e Justinianit, sigurisht me shpresën që nxënësit të identifikohen me doktrinat fetare të kohës së tij.


Kur i lexon dhe i dëgjon këto ide e i sheh këto aktivitete, njeriu e ka zor ta kuptojë se a e kanë seriozisht apo është një mahi e radhës me veten. Mirëpo, disa nga emrat që janë përmendur si pjesëmarrës në këtë maskaradë, nuk lënë hije dyshimi se ata e kanë seriozisht, meqë u mungon tërësisht talenti për të bërë humor. Fytyrat e tyre të vrenjtura më parë ta kujtojnë Don Kishotin e përvuajtur në shërbim të një kauze të madhe, se sa Sanço Pançën naiv.

Edhe pse kjo ide e këto aktivitete vërtet duken më shumë tragjikomike, prapë se prapë, ia vlen të shpjegohet diçka seriozisht lidhur me këtë punë. Puna e parë që duhet të shpjegohet pa dyshim është kjo: kush është Justiniani dhe çfarë ka bërë që të meritojë nderimin e shqiptarëve, qoftë dhe vetëm të një grupi fanatikësh të bizantinizmit? Justiniani ka lindur dikund në Ballkan, por studiuesit seriozë nuk e dinë tamam se ku. Bizantinologu i njohur, Ogyst Baji, në librin “Perandoria e Bizantit” nuk sjell ndonjë shënim për vendlindjen e Justinianit. Gjon Julius Norvich, shkruan se “Justiniani lindi në vitin 482 në Trakë”. Ndërsa, Georg Ostrogorski shkruan se është “i lindur në fshatin Tauresio (ndoshta pranë Nishit...”. Këta dijetarë kanë shkrirë mend për studimin e Bizantit, por kanë mbetur me dilema për vendlindjen e tij,

ndërsa zbuluesit tanë të shoqatës “Anton Pashku” dhe të asaj “Gollaku”, pa u bërë hiç syri tërr, e kanë gjetur Turuqicën si vendbanim të Justinianit.

Edhe sikur të ishte e mirëqenë e dhëna se paskësh lindur në Turuqisë, çfarë arsyes ka që të shënohet emri i tij nga shqiptarët e sotëm? A ka bërë ndonjë gjë të mirë Justiniani dhe Bizanti për ilirët/ shqiptarët? Kjo pyetje kërkon shpjegime të gjata, por këtu po sjellim vetëm mendimin e Reginald Hiberit, i cili ka thënë se “lidhja e gjatë me Bizantin, i la shqiptarët pa identitet politik”. Nëse dikush të ka lënë pa identitet politik dhe ti e kremton emrin e tij, kjo do të thotë se vërtet ke mbetur jo vetëm pa identitet politik, po edhe kulturor e etik. E vërteta është se sundimtarët bizantinë, duke përfshirë edhe Justinianin dhe gruan e tij, Teodorën, janë dalluar për sundim mizor, për masakra nga më të egrat në historinë e njerëzimit. Nga ana tjetër, prejardhja etnike nuk është kurrë një arsye për ta glorifikuar e përjetësuar emrin e një sundimtari të një shteti okupator. Me kësi kriteri shqiptarët do të duhej të glorifikonin edhe emrin e udhëheqësit serb, Karagjorgjit, për të cilin historianët romantikë shqiptarë pohojnë se kishte prejardhje shqiptare. Edhe Mark Milani do të na dilte si vëlla dëshiri me kësi kriteri. Me këtë kriter shqiptarët duhet të glorifikojnë edhe pushtetarë grekë si Pangallosi, që kishte tamam prejardhje shqiptare. Por, me kësi kriteri, politikanë të kohës sonë si Sejdo Bajramoviqi, Sinan Hasani, Ali Shukriu e Kolë Shiroka, duhet të glorifikohen meqë kanë qenë udhëheqës në një shtet të madh. (Kur krahasohen liritë e shqiptarëve në shtetin ku ka qenë pushtetar Sejdo Bajramoviqi, me liritë që kanë pasur ilirët në shtetin e Justinianit, Sejdoja na rezulton trim me fletë për nga shqiptarizmi.) Në fakt, Bizanti ka qenë ferri mbi tokë për ilirët, edhe në kohën e Justinianit e edhe më vonë.

Prandaj, përpjekjet për ta infiltruar një figurë të tillë në jetën e sotme kulturore, publike dhe kombëtare,



me kriterin gjenetik, është shumë absurde. Ka shumë njerëz në histori që kanë pasur prejardhje ilire a shqiptare. Nuk mund të infiltrohen e as të rehabilitohen me këtë kriter, ata që nuk kanë kontribute faktike në zhvillimin e jetës së një populli a kombi. Prandaj, edhe përpjekjet për të sajuar një dashuri për sundimtarë bizantinë e për Bizantin janë absurde. Ostrogorski jep këtë definim se çfarë në fakt ishte Bizanti: "strukturë shtetërore romake, kulturë greke dhe besim i krishterë: këto janë burimet kryesore kulturore të zhvillimit të Perandorisë bizantine". A mund të na tregojë dikush se cila nga këto elemente të trashëgimisë bizantine janë elementet thelbësore të identitetit shqiptar? Për vete e di se asnjëra nuk është.

Këtë lloj bizantinofilie e kanë me arsyë grekët, e deri diku edhe serbët dhe rusët, por ne nuk kemi asnjë arsye që ta kultivojmë. Identiteti kombëtar i shqiptarëve nuk është përfutur mbi themelin e bizantinizmit e të ortodoksisë. Dhe nuk do të transformohet në atë drejtim as në të ardhmen.

Atëherë pse bëhet kjo përpjekje e infiltrimit të bizantinizmit në jetën e sotme shqiptare në shtetin e ri të Kosovës, i cili ende po i vuan pasojat e presionit panortodoks e pansllavist, në instancë të fundit edhe bizantinist?

Qëllimi përfundimtar i entuziastëve bizantinofilë, të mbledhur rreth shoqatës "Anton Pashku" dhe asaj "Gollaku" është që si e si ta minojnë realitetin e tashëm politik, kulturor, kombëtar e fetar të shqiptarëve të Kosovës. Ata duan si e si të gjejnë rrënjë të tjera të identitetit shqiptar, veçmas të atij fetar. Në këtë eufori rrënuese janë në gjendje ta kthejnë fitimtar mbi qiejt e Kosovës së pavarur edhe kryqin e Bizantit, për ta zëvendësuar disi kryqin e thyer të Serbisë.

Entuziastët bizantinofilë e dinë se me kënd kanë punë: në një vend ku një hajni mashtron ministrat, në një vend ku një djalë i ri që ngjet si bodigard i ndonjë lideri arrogant prezantohet si pasardhës i Skënderbeut, në një vend ku kontrabandohet Viagra me kamionë nga zyrtarët e doganave, edhe ky diversion i radhës mund të pijë ujë. Mund të pijë ujë sepse elitës së këtij vendi ia ka pirë sorra mendtë. ■

Qendra e Studentëve e gatshme për të pritur banorët e rinj

Hapen dyert e kon

Gjatë këtij viti akademik, Qendra e Studentëve (QS) krahas 3 mijë e 73 shtretërve u ka ofruar studentëve edhe dy racione ushqimi, bibliotekën, sallat e leximit dhe të internetit si dhe kushte tjera për aktivitete kulturore dhe sportive.



Gëzim QERIMI

Këtë vit kompleksit të Qendrës së Studentëve do t'i shtohet edhe një konvikt i ri, konvikti numër gjashtë, i cili bashkë me konviktet e tjera ofron 3073 shtretër për studentë.

Si zakonisht, edhe këtë vit, përparësi për t'u bërë banorë në Qytetin e Studentit do të kenë të gjithë studentët e Kosovës, por edhe ata nga vendet fqinje nga Shqipëria, Mali i Zi dhe regjionet e tjera.

Sipas drejtuesve me të lartë të QS, përgatitjet teknike janë bërë në të gjitha konviktet dhe është duke u punuar në vazhdimësi, kurse në tetor pritet që e tërë pjesa teknike të jetë e gatshme për vendosjen e studentëve.

Sa i përket mensës së studentëve, këtë vit drejtuesit e QS-së premtojnë se do të mundohen të rrisin kualitetin e shërbimeve dhe cilësinë e ushqimit. Krahas strehimit dhe ushqimit, Qendra do të afrojë më tepër salla të leximit brenda për brenda konvikteve si dhe kushte për sport e rekreacion.

Sipas drejtorit të Qendrës së Studentëve, Bejtush Uka,

banimi i rregullt për studentë fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 qershor, ndërsa në muajin korrik dhe shtator, në pajtim me kërkesat e studentëve organizohet banimi me recepcion. Sivjet ky banim është organizuar në konviktin numër tre, ndërsa në muajin shtator ky shërbim është ofruar në konviktin numër katër. Gjithashtu, z. Uka bëri të ditur se gjatë muajit korrik Qendra ka ofruar banim dhe ushqim edhe për studentët e Universitetit Veror, të cilët janë financuar nga MASHT-i.

Konkursi për pranimin e studentëve në Qendrën e studentëve është publikuar më 10 shtator. Në këtë konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë kryesisht studentët që konkurrojnë për herë të parë, të cilët janë pranuar në Universitetin e Prishtinës dhe studentët të cilët kanë banuar më herët ose vitin e kaluar, të cilët i përkasin vitit të dytë deri në vitin e gjashtë të studimeve.

Më 1 tetor fillon vendosja e studentëve nëpër konvikte

Komisionet për- katëse do të bëjnë selek- sionimin e



Konvikteve për 3073 studentë

përfituesve të banimit, gjithmonë në pajtim me kriteret e caktuara më parë. Në këtë formë, në fund të muajit shtator do të përzgjidhen përfituesit dhe më 1 tetor do të fillojë vendosja e studentëve nëpër konvikte.

Po ashtu, për këtë vit akademik, MASHT-i pritet të marrë vendim që t'i lirojë nga pagesa pjesërisht apo plotësisht studentët invalidë të luftës, fëmijët e dëshmorëve dhe studentët, familjet e të cilëve jetojnë në asistencë sociale, numri i të cilëve pritet të jetë mbi 500 veta. Vite me radhë, studentët që kanë përfitur nga ky vendim janë sistemuar në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve. Studentët e kategorive të lartpërmendura pritet që të përfitojnë edhe këtë vit akademik dhe të sistemohen në Qendrën e Studentëve sipas kategorive:

-Invalidët e luftës me invaliditet mbi 50% pritet të lirohen nga të gjitha obligimet financiare;

-Fëmijët e dëshmorëve dhe invalidë të luftës lirohen nga detyrimet financiare dhe nga pagesa për vendosje;

-Studentët me familje me asistencë sociale parashihet të lirohen 50 % nga strehimi, si dhe Parlamenti Studentor, si më parë, pritet që të lirohet vetëm nga pagesa e banimit.



Këtë vit QS edhe me bibliotekë, sallë të leximit dhe sallë të internetit

Sa i përket ushqimit në mensë, drejtori Uka thekson se vitin e kaluar nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga studentët abonentë në lidhje me kualitetin dhe sasinë e ushqimit. "Punëtorëve të mensës çdo gjashtë muaj u bëhet kontrolli shëndetësor – sanitar siç është paraparë me ligj. Këto shërbime tani për tani ofrohen vetëm në mensën që gjendet në kompleksin e konvikteve ngase mensa te Fakulteti Teknik nuk funksionon për arsye se ende shfrytëzohet nga Trupat

Mbrojtëse të Kosovës – TMK", - ka theksuar Uka.

Ai ka shpjeguar më tej se Shërbimi Teknik ka kryer në mënyrë permanente intervenimet nëpër të gjitha objektet, si intervenimet në rrymë, ujë, kanalizim, ngrohje qendrore si dhe intervenime të tjera në rast të defekteve eventuale.

Qendra ka në funksion 24 orësh edhe Shërbimin e Sigurisë, pjesëtarët e të cilit kujdesen për sigurimin e Objekteve të Qendrës. Në kuadër të këtij shërbimi funksionojnë edhe zjarrfikësit.

Vitet e kaluara studentët janë përballur me vështirësi për shkak të mungesës të furnizimit të rregullt me rrymë elektrike dhe ngrohje.

Mergim Lushtaku – Kryetar i organizatës "Paqja Studentore" theksoi se do të bëhen përpjekje maksimale që ky problem të zgjidhet në bashkëpunim të ndërsjellë mes Parlamentit Studentor, Ministrisë së Energjetikës, Qendrës së Studentëve dhe KEK-ut.

Një risi që është mirëpritur nga të gjithë studentët është hapja e bibliotekës, e sallës së leximit dhe e sallës së internetit në Qendrën e Studentëve - theksoi z. Lushtaku. Salla e leximit tani ofron mundësi që një numër më i madh studentësh të studiojnë deri në orët e vona të natës. Kjo sallë është një lehtësim për studentët, duke pasur parasysh kapacitetet e limituara për të ofruar vend për të studiuar nga ana e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare dhe të Fakulteteve të Universitetit të Prishtinës.

Në konviktin e ri, banues edhe profesorët udhëtarë të UP-së

Kompleksit të Qendrës së studentëve së shpejti do t'i shtohet edhe konvikti numër gjashtë, i cili pritet të jetë i gatshëm deri nga gjysma e tetorit.

Sipas parashikimeve, ky konvikt do të jetë i gatshëm nga data 1-15 tetor. Për realizimin e projektit të konviktit numër gjashtë, Ministria e Arsimit ka ndarë afro 1 milion e 600 mijë euro. Konvikti është një objekt me standarde të konvikteve evropiane. Dhomat e këtij konvikti janë kryesisht një dhe dy krevatesh, gjithashtu tualetet janë brenda dhomës.

Një pjesë e këtij konvikti është paraparë edhe për profesorë të Universitetit të Prishtinës dhe asistentë, të cilët udhëtojnë, si dhe për studentët që studiojnë master. Kjo i përket një pjese të veçantë të konviktit në kuadër të së cilës janë edhe dy apartamente për mysafirë si dhe dy apartamente të tjera për studentët me aftësi të kufizuara.

Konvikti i ri do të ketë gjithsej 308 shtretër. 90 dhoma do të jenë me nga një shtrat, 97 me nga dy shtretër, dhe 16 dhoma me nga një shtrat për 16 profesorë të Universitetit të Prishtinës.

Intervistë me z. Talip Aktash, drejtor ekzekutiv i Fondacionit për Arsim dhe Kulturë "Atmosfera"

Investimi ynë është për njeriun, pa ma

- Duhet përfituar nga prezantimet dhe shtrirjet edukativo-arsimore që ka bërë "Lëvizja Gylen" në mbarë botën
- Njerëzit mund të duhen njëri me tjetrin edhe pa interes
- Idetë e Gylenit janë shtrirë në mbi 130 shtete
- Kam shpresën se pas pavarësisë së saj, Kosova do të ketë zhvillime drastike në arsim dhe në çdo aspekt të jetës

Intervistoi: Demir Reshiti

Në tetor, Fondacioni për Arsim dhe Kulturë "ATMOSFERA" mbush 4 vjet që zhvillon aktivitetet në Kosovë. Kjo organizatë është pjesë e Lëvizjes së njohur "Gylen" e cila ka shtrirje në mbi 130 vende të botës. Për të mësuar më për së afërmi për aktivitetin dhe të arriturat e këtij Fondacioni, zhvilluam një intervistë me drejtorin ekzekutiv z. Talip Aktash.

PAQJA: Kur është themeluar fondacioni "Atmosfera" dhe për çfarë qëllimi?

Aktash: Fondacioni për Arsim dhe Kulturë "ATMOSFERA" u themelua më 1 tetor të vitit 2004. Synimi dhe qëllimi i themelimit të këtij Fondacioni është ofrimi i një ndihmese edukimit dhe shkollimit të të rinjve në Kosovë, dhe për t'u treguar njerëzve se vetëm së bashku mund të bëjmë të ngadhënjë dituria kundrejt injorancës, uniteti kundër përçarjes dhe problemi i varfërisë mund të zgjidhet vetëm me punë të zellshme.

Duhet përfituar nga prezantimet dhe shtrirjet edukativo-arsimore që ka bërë "Lëvizja Gylen" në mbarë botën

PAQJA: Çfarë aktivitetesh keni zhvilluar deri më tani?

Aktash: Fondacioni "Atmosfera", duke i qëndruar besnik qëllimit të themelimit, deri më tani ka realizuar promovimin e 4 librave të M.F.Gylenit (të përkthyer në shqip): "Nga fara te lisi" (Edukimi familjar dhe brezi i ri nga një këndvështrim tjetër), "Kriteret" (Dritat në rrugë), "Drejt një qytetërimi botëror me Dashuri dhe Tolerancë" dhe "Dritë e pashuar Hz.



Talip Aktash është i lindur në qytetin Cankara të Turqisë. Shkollimin e mesëm e ka mbaruar në Ankara. Ka diplomuar në fakultetin juridik të universitetit "El-Az-har" të Kajros. Pas përfundimit të fakultetit në Kajro, ka punuar 1 vit në kursin e gjuhëve të huaja për studentë të huaj, më pas ka punuar 8 vjet si mësimdhënës në Shqipëri, ndërsa që nga tetori i vitit 2004 drejton Fondacionin për Arsim dhe Kulturë "Atmosfera" në Kosovë.

Muhammedi a.s."; dy simpoziume: "E vërteta e krijimit dhe evolucioni" dhe "Domosdoshmëria e dialogut ndërfaqar e ndërkulturor për paqen botërore"; shëtitje me intelektualët nga Kosova në Shqipëri (3 herë) e Turqi (2 herë), si dhe iftaret e tolerancës për çdo vit.

Në qytete të ndryshme kemi mbajtur programe për Datëlindjen e Profetit Muhammed a.s., kemi dhënë kurse të ndryshme në Prishtinë dhe Prizren për nxënësit e shkollave të mesme dhe nga ky vit kemi startuar me konvikt në Prishtinë dhe Prizren. Aktivitetet tona në këto vende po vazhdojnë.

PAQJA: Thatë se keni bashkëpunuar me një numër relativisht të madh të intelektualëve të Kosovës, madje disa prej tyre i keni dërguar edhe në Turqi. A do të vazhdoni me të njëjtën praktikë edhe në të ardhmen?

Aktash: Për arsye të globalizimit të botës, njerëzit tani ndikohen shumë më shpejt nga njëri-tjetri. Ne mendojmë se duhet përfituar nga prezantimet dhe shtrirjet edukativo-arsimore që ka bërë "Lëvizja Gylen" në mbarë botën. Për

këtë arsye do të vazhdojmë dërgimin e intelektualëve kosovarë në Turqi, për ta parë së afërmi qendrën e kësaj nisme.

PAQJA: Tani pas pavarësisë të Kosovës a mendoni se do të krijohen kushte më të mira për shtrirjen e aktivitetit të organizatës suaj?

Aktash: Padyshim se pavarësia e Kosovës për ne është e rëndësishme, ngase psikologjitë tashmë të qeta (relaksuara) të njerëzve me të cilët takohemi e lehtësojnë shumë punën tonë. Kështu që ne po fitojmë mundësi lëvizjeje më të lehtë në Republikën e Kosovës së pavarur dhe sovranë. Tashmë para nesh nuk ka ndonjë mjegullnajë.

PAQJA: Çfarë bashkëpunimi keni me organizatat e ngjashme që zhvillojnë aktivitetet në Kosovë?

Aktash: Ne jemi të gatshëm (hapur) të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet. Veçanërisht, kemi pasur aktivitete të përbashkëta me Bashkësinë Islame, si: shëtitje dhe konferenca të ndryshme. Dëshirojmë që edhe më tutje të vazhdojmë kështu.

rrë parasysht besimin a ideologjinë e tij

PAQJA: *Me çfarë problemesh jeni balafaquar gjatë kësaj periudhe të veprimtarisë suaj në Kosovë?*

Aktash: Kosova është vendi ku traditat tona kulturo-historike si të thuash kanë shumë pika të përbashkëta. Nuk kemi hasur në ndonjë pengesë serioze gjatë ushtrimit të aktivitetit tonë. Përkundrazi, njerëzit e saj janë shumë të butë dhe të ngrohtë ndaj nesh.

Njerëzit mund të duhen njëri me tjetrin edhe pa interes

PAQJA: *"Atmosfera" është pjesë e 'Lëvizjes Gylen' e cila është duke u shtrirë nëpër shumë vende. Na njoftoni me veprimtarinë e 'Lëvizjes Gylen' në Evropë dhe më gjerë.*

Aktash: "Lëvizja Gylen" dëshiron që të jetë e pranishme në mbarë botën vetëm e vetëm që të jetohet (shijohet) paqja sërish. Për këtë arsye i është vënë punës me seriozitet dhe sinqeritet që të formojë të ashtuquajturat 'ishuj' të paqes. Këtë funksion e kryejnë shkollat dhe qendrat kulturore-edukativo-arsimore, si dhe qendrat për dialog ndërfaqësor dhe ndërkulturor.

Evropa është një kontinent që ka përjetuar 2 luftëra botërore dhe duke nxjerrë mësim nga këto është forcuar.

Ngjarjet që po ndodhin anekënd botës po i drejton (udhëzon) me këtë fuqi.

"Lëvizja Gylen" mundohet t'i arsimojë fëmijët e feve dhe racave të ndryshme, duke hapur shkolla të shumta edhe në Evropë, siç ka bërë në kontinentet e tjera. Në të njëjtën kohë, duke realizuar dialogë me përfaqësues të feve ndryshme, po përpiqet t'i përpunojë temat se "fetë nuk janë shkaqet e luftës, por themelet e paqes". Po mundohet të mësojë njeriun përëndimor se "njerëzit mund të duhen njëri me tjetrin edhe pa interes". Frytet e kësaj përpjekjeje kanë filluar të shfaqen.

Idetë e Gylenit janë shtrirë në mbi 130 shtete

PAQJA: *Dijetari i shquar Fejtullah Gylen, sivjet është shpallur intelektual i madh në radhën e intelektualëve që jetojnë... Si e vlerësoni ju këtë dhe sa do të ndikojë në përhapjen e Lëvizjes që mban emrin e tij?*

Aktash: Fejtullah Gylen është një dijetar i madh 70 vjeçar, prej të cilave 50 vite i ka harxhuar për formimin e mirëfilltë të njerëzve. Vite me radhë është përpjekur dhe po përpiqet ende t'i japë fund injorancës, varfërisë e përçarjeve. Sipas mendimit të tij, problemi i vetëm është mungesa e njerëzve të arsimuar. "Nëse

njerëzit do t'i arsimonim, dhe bashkë me këtë t'u jepnim një edukatë morale (t'i bënim të moralshëm), atëherë vendi përkatës do të jetë më i pasur, më i qetë". Sipas Gylenit, mësuesit dhe biznesmenët që i vlerësojnë idetë e tij, kanë filluar punën e edukimit dhe dialogut në Turqi dhe përafërsisht në 130 shtete të botës. Si rezultat i kësaj, bota e njohu Gylenin dhe e shpalli atë dijetarin nr.1 dhe më me ndikim të kohës (Revista Amerikane për marrëdhënie ndërkombëtare "The Foreign Policy" dhe ajo angleze "The Prospect" e kanë publikuar këtë gjatë një studimi dhe kërkimi disa mujor). Edhe kjo e lehtësoi punën tonë. Para së gjithash, u formua besimi (siguria). Ata që shikonin nga jashtë, kuptuan se punët që po bëheshin ishin të qëlluara dhe të dobishme për shoqërinë dhe u afruan për të ndihmuar.

PAQJA: *Para disa muajsh në Prishtinë keni organizuar një simpoziun mbi dialogun ndërfaqësor. Sa jeni të kënaqur me rezultatet e këtij simpoziumi dhe a mendoni që edhe në të ardhmen të organizoni aktivitete të ngjashme?*

Aktash: Siç e dini, Kosova më 1999 pati luftë. Shkaqet e saj janë të shumta, por njëra prej tyre ishte prania e etnive dhe feve të ndryshme. Kosova dhe shqiptarët në të, gjatë historisë, kanë jetuar



Grup intelektualësh nga Kosova gjatë një vizite në Shqipëri, organizuar nga Fondacioni për Arsim dhe Kulturë "Atmosfera"

në paqe me turqit, boshnjakët e serbët, brenda saj. Kjo u duhet ritreguar njerëzve, në mënyrë që të mos ripërsëritet lufta, sepse Kosova është një vend i sigurt për çdo qytetar të saj, pa marrë parasysh se çfarë feje apo kombësie i takon ai. Pas pavarësisë së Kosovës, vëmendja e botës është kthyer në këtë vend me pyetjet se çdo të bëhet tash e tutje? A do të ketë edhe ndonjë problem tjetër? Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, realizuam një simpozium të tillë. Aktivitet e kësaj natyre do të vazhdojnë.

PAQJA: *Prej këtij viti keni startuar edhe me konvikte për nxënës dhe studentë. Çfarë kushtesh ju ofroni atyre dhe si është bërë përzgjedhja?*

Aktash: Arsimiti në fshatrat e Kosovës është i dobët. Ne menduan se duhej ta përkrahim atë. Për këtë, në Prizren hapëm konviktin për nxënësit e shkollave të mesme, e në Prishtinë - konviktin për studentët e universiteteve. Kështu filluan punën të dy konviktet. Marrë në përgjithësi, përparësi u japim nxënësve të zgjuar nga fshatrat, por me mundësi të dobëta ekonomike. Perspektiva më e rëndësishme është edukimi dhe arsimimi. Besojmë se me këtë do të zgjidhen të gjitha problemet që ka shoqëria.

Kam shpresën se pas pavarësisë së saj, Kosova do të ketë zhvillime drastike në arsim dhe në çdo aspekt të jetës

PAQJA: *Ju vini në Kosovë pas një pune disavjeçare në Shqipëri ku keni punuar si mësimdhënës. A mund të na tërhiqni një paralele mes zhvillimit të arsimit në Shqipëri dhe në Kosovë?*

Aktash: Që të dy janë i njëjti popull, por përleshjet ideologjike të shekullit të fundit e kanë grisur arsimin. Shqipëria në kohën e Enver Hoxhës ka përjetuar një komunizëm të ashpër, duke kaluar 60 vite larg zhvillimeve, e izoluar ndaj botës. Për shkak se nuk mundi t'i përshkatojë menjëherë hapit të demokracisë që e pasoi atë periudhë të errët dhe nuk mundi të stabilizohej drejtimit të duhur, pati vështirësi në fillim. Prej kësaj nuk shpëtoi as arsimi. Por tani po shkohet drejt përmirësimit. Shkollat private dhe universitetet e ardhura nga jashtë, krijuan një ambient garues, si dhe mundë-


suan që shkollat shtetërore të vetëdijesoheshin. Për shkak se kanë mendimin për t'u anëtarësuar në BE, punën e kanë marrë me shumë seriozitet. Për momentin, zhvillimi i arsimit në Shqipëri është i kënaqshëm.

Edhe Kosova i ka përjetuar problemet e ngjashme. Këtu njerëzit kanë migruar jashtë vendit për arsim, për këtë arsye e njohin botën fort mirë. Kam shpresën se pas pavarësisë së saj, Kosova do të ketë zhvillime drastike në arsim dhe në çdo aspekt të jetës, duke u shndërruar një vend më të pasur, më të lumtur.

PAQJA: *Cilat janë projektet që mendoni t'i realizoni në të ardhmen?*

Aktash: Investimi ynë është për njeriun, pa marrë parasysh besimin a ideologjinë e tij. Shpresojmë të realizojmë plane të tilla për të rinjtë në kurse, konvikte e shkolla.

PAQJA: *Në fund, cili do të ishte mesazhi i juaj për lexuesit e revistës PAQJA?*



Aktash: Revista PAQJA është respektuese e vlerave kombëtare e shpirtërore. Po përpiqet me sa i vjen për dore për të kontribuar në zhvillimin e Republikës së Kosovës. Po i jep rëndësi formimit të të rinjve. Është respektuese për të gjitha shtresat shoqërore dhe etnike dhe qëndron në pozitë kryesuese në paqen e vendit, njashtu siç tregon vetë emri i saj. Sapo ka hyrë në jetën gazetareske të Kosovës, por është duke u zhvilluar me ritme të shpejta. Lexuesit e saj duhet të bëjnë më shumë për ta rritur numrin e tirazhit të saj. U uroj fat në jetën gazetareske. ■



Sa peshon shporta familjare gjatë muajit Ramazan?

Rritet qarkullimi, rriten çmimet

Vlerësohet se qarkullimi gjatë muajit Ramazan është shtuar deri në 20%, sidomos në produktet bazë të ushqimit, si: vaji, mishi, vezët, etj. Sipas blerësve, edhe çmimet kanë pësuar një ngritje gati në 20%, gjë që ka bërë që te disa qytetarë shporta familjare të varfërohet ndjeshëm.



Osman D. GASHI

Përkundër faktit që Kosova gjendet në një krizë ekonomike dhe ka një përqindje të lartë të papunësisë e varfërisë, në muajin e Bekuar të Ramazanit qytetarët shpenzojnë më shumë për ushqime e gjëra të tjera, duke e dalluar këtë muaj nga muajt e tjerë të vitit.

Kjo gjë, siç duket, ju shkon përshtat edhe tregtarëve të cilët duke e parë rritjen e qarkullimit i shtrenjojnë çmimet, veçmas të artikujve ushqimorë.

- A ka pasur ngritje të shitjes në muajin e Ramazanit? - A ka pasur luhate çmimesh? - Çfarë produkte blihen më shumë? Këto janë disa nga pyetjet që ua kemi parashtruar tregtarëve dhe blerësve në kryeqytet.

Ndërkohë që qytetarët ankohen për ngritjen e çmimeve, tregtarët nuk e ndajnë këtë mendim, madje ata pohojnë se gjatë muajit të Ramazanit shënohen edhe zbritje të çmimeve.

Të dyja palët (tregtarët dhe blerësit) janë dakord se gjatë këtij muaji ka një rritje të konsiderueshme të shitblerjes.

Vlerësohet se qarkullimi në këtë muaj është shtuar deri në 20%, sidomos në produktet bazë të ushqimit, si: vaji, mishi, vezët, etj.

Sipas blerësve, edhe çmimet kanë pësuar një ngritje gati në 20%, gjë që ka bërë që te disa qytetarë shporta familjare të varfërohet ndjeshëm.

Më shumë kërkohen produktet vendore

Sipas pronarit të Marketit "Viva" në Prishtinë, gjatë këtij muaji vërehet një

qarkullim më i madh dhe nuk ka luhate të çmimeve të produkteve ushqimore. Madje ai pohon se disa prej artikujve gjatë muajit të Ramazanit janë liruar. Prej produkteve që shiten më së shumti janë artikujt elementarë ushqimorë si dhe hurmat e jogurtë të ndryshëm.

Është për t'u theksuar fakti se qytetarët kërkojnë më shumë produkte vendore, sidomos ato të bulmetit.

Të njëjtin mendim me bashkëbiseduesin e parë e ndan edhe punëtori i marketit "Ben Af". Ajo pohon se vërehet një shtim i shitjes së prodhimeve ushqimore gjatë muajit të Ramazanit, ndërsa prodhimet e tjera shiten njëllë.

"Çmimet kanë mbetur të njëjta. Nuk ka ndryshime dhe qytetarët janë të kënaqur si me çmimet, po ashtu edhe me shërbimin tonë ndaj blerësve" - thekson kjo punëtore.

Ndërkaq në marketin "Inter Eminex", pohojnë se qarkullimi gjatë këtij muaji është ngritur për 15%, ndërsa çmimet kanë mbetur ato që kanë qenë më parë, përveç çmimit të vezëve dhe dy tre artikujve të tjerë që janë shtrenjtuar pak. "Klientët janë të kënaqur me shërbimet e çmimet e produkteve që ne shesim. Nuk na ka ndodhur që të kemi ndonjë

ankesë nga ndonjë qytetar për ndonjë gjë. Është një e mirë që qytetarët janë sensibilizuar në blerjen e produkteve vendore sepse kështu mund ata mund të ndihmojnë Kosovën", shprehet punëtori i këtij marketi.

Qytetarët të kënaqur me shërbime por jo edhe me çmime

Arlinda Fasliu nga Prishtina thekson se në këtë muaj ka blerë më shumë artikuj se sa gjatë muajve të tjerë, sidomos artikuj ushqimorë, kurse për çmimet ajo pohon se në përgjithësi nuk kanë ndryshuar, vetëm disa artikuj janë shtrenjtuar.

Ndërkaq Bedri Llapashtica, të cilin e takuam duke blerë në njërin nga shitoret e kryeqytetit, për revistën tonë ka pohuar se ka vërejtur një ngritje të çmimeve të artikujve ushqimorë në masën deri në 20%. Bajrami pohon se për të është e rëndësishme që prodhimet të jenë cilësore, pavarësisht nëse janë ato vendore ose nga importi. Ky qytetar kryeqytetas shprehet i mllefosur ndaj tregtarëve të cilët, sipas tij, gjatë muajit ramazan i shtrenjojnë artikujt, ndërsa për Krishtlindje e festa të tjera i lirojnë!



Fati i njeriut që sfidoi shkencën (II)

Sfidimi në matematikë dhe

Nëse dikush më bind se unë nuk mendoj dhe veproj drejt, do të isha i gëzuar dhe do të ndryshoja, sepse e gjurmoj të vërtetën prej së cilës njerëzimi nuk është lënduar kurrë - kishte thënë profesor Rifat Gjota në përballjet e përditshme me presionet obskurantiste që i bëheshin gjatë jetës së tij.




Sabri HALILI

Matematika duhet mësuar, ajo i sjell trurit (mendjes) harmoni” - thotë shkencëtari i madh Lomonosov.

Guximi dhe vendosmëria e Rifatit për t'u përballur me realitete të reja, madje edhe të hidhura, do të vërtetohen me idetë e reja edhe sa i përket shkencës së matematikës, gjegjësisht pikëpamjet e tij për sferizmin si një vështrim tjetërfare nga aktualiteti.

Çfarë lidhje ka sferizmi, matematika, me profesionin e tij të vërtetë dhe me zbulimin e makinave komplementare? Për laikët kjo ishte dhe është paksa e vështirë të kuptohet, por e gjithë kjo ka një lidhje logjike, filozofike, por edhe praktike natyrore. Ideja për shikim tjetërfare, në bazë të sferës, për pakufishmërinë e dukurive natyrore që dominoi botën që nga kohët më të lashta, tashti nga profesor Gjota shikohet në një këndvështrim tjetër, real. Kjo ide kishte lindur te Rifat Gjota që nga viti 1961, kur ishte student në Shkup, kur kishte rënë herën e parë në provimin e matematikës. Në këtë rast, Rifati i thotë profesorit: “Nuk ka problem, bota është e rrumbullakët dhe ne do të shihemi në shtator”. Pra, arsye kryesore e kësaj “mosmarrëveshje” me profesorin ishte se ai qysh si student i zgjidhte detyrat në bazë të sferizmit, botëkuptim që nuk mund ta merrnin me mend në atë kohë, sikurse as sot, profesorët, kolegët e Rifatit. Kjo edhe i sillte



komplikime në raport me përballjen e tij me sistemin ekzistues të shikimit dhe qasjes në matematikë. Përkundër kësaj, ai asnjëherë nuk ka pasur guxim ta bëjë sferën nga droja se kjo mund të shkaktoj një erupsion dhe moskuptim në mesin e matematikanëve, ashtu siç ndodhi më vonë. Megjithatë, idetë e reja për atë që deri tashti ishte e padukshme në matematikë-imagjinare, duke e thyer këtë botëkuptim me idenë se nuk ka imagjinare, nuk ka pakufi në funksionet natyrore, i ndihmoi shumë edhe në zbulimin e motorit tashmë të njohur edhe botërisht, atë komplementar. Sipas botëkuptimit të Gjotës, nuk ka asnjë funksion natyror pa kufi, por çdo gjë sillet rreth sferës, çdo gjë sillet në rreth qoftë edhe në rreth të deformuar.

“Shpërthim” pas ndrydhjes së gjatë të ideve të reja, kundërshtime të radhës

Për këto botëkuptime ai nuk foli deri vonë, vetëm për shkak të injorimit, rezistencës dhe përjashtimit që i bënin, së pari disa prej kolegëve të tij.

Për herë të parë profesor Gjota “e shpoi sferën” dhe filloi të dalë në sipërfaqe me veprimet konkrete faktike për idetë e tij rreth sferizmit në vitin 1994. Atij, në atë periudhë, i erdhi një forcë e jashtëzakonshme, duke filluar me një veprim shumë të thjeshtë, ndoshta primitiv, por shumë domethënës. Dy shisheve të kokakolës ua hoqi pjesët e fundit dhe improvizoi një sferë dhe filloi një ush-

trim konkret në bazë të mendimeve të reja, në bazë të sferizmit.

Vështrimi sensacional i prof. Gjotës në sferizëm paraqet një thirrje dhe një vërejtje për mendimet e ngurta dhe stereotipe të tyre që shkencën e kuptojnë si të përfunduar. Përkundër mendimeve të tilla të ngurta dhe përkundër faktit se të tillët gjithnjë ishin pengesë për profesor Gjotën, dhe të cilët pëshpëritnin se “Rifati po flet me tela...”, ai ecë gjithnjë, sigurt në hap me natyrën dhe plotësisht i harmonizuar me të. Dukuritë natyrore ai i shikon në bazë të ligjeve natyrore dhe se nëpërmjet “aparitit” më të ri logjik bën ndriçimin e çështjeve të cilat një kohë të gjatë ishin tema tabu. Por, profesor Gjota me vështrimet e tij edhe nga sferizmi, na mëson se në këtë botë reale nuk ka gjëra të pamundshme dhe se çdo gjë është në lëvizje e në ndryshim të përhershëm. Mu për këtë edhe veprimtaria praktike e njerëzve, duhet të synojë ndryshime të përhershme të botës dhe fenomenet duhet të vështrohen me syrin inventiv, hulumtues, jo si imagjinare, jo të pakufishme.

Profesor Gjota beson se me zbulimin e tij nga sferizmi do të mundësojë që edhe shkencat e tjera ta zgjidhin problemin e pakufishmërisë, asimtotave vertikale, horizontale, të pjerrëta, etj. Dhe tash e tutje marrin një formë të re, sepse ligjshmëritë që i kanë vërejtur në rrafsh, tashti duken në sferë, vështrohen nga një kënd i ri dhe përfitohen nocione të reja. Në literaturë, edhe nga ana e filozofëve të mëdhenj ka qenë i padefinuar kuptimi i

kundërshtimet ndjellakeqe

pakufishmërisë, të cilët nuk kanë arritur ta lidhin fillimin dhe mbarimin e kohës dhe hapësirës. Me anë të sferizmit, që e përfaqëson profesor Gjota, është arritur një formë e re e definimit të pakufishmërisë si dhe të kuptimit të madhësive dhe është bërë jetësimi i imagjinare që tash e tutje duhet të jetë realitet.

Për vështrimet më të reja të tij në matematikë, profesor Gjota ishte i vetëdijshëm se nuk do të haste në mirëkuptimin e bashkëkohësve të tij, të kolegëve dhe të shumë kuazishkencëtarëve, me mendje të ngurtë dhe me "perde" para syve, sepse ata gjërat i shihnin në rrafshin real. Megjithatë, ai ndoqi shembullin e shkencëtarëve të mëdhenj botëror, të cilët, me gjithë faktin se u injoruan dhe u dënuan në forma të ndryshme nga bashkëkohësi e tyre për mendimet e tyre shkencore, ata nuk u larguan asnjëherë nga përcaktimet e tyre. Duke u bazuar në sukseset shkencore të prof. Gjotës që i arriti me makinat komplementare dhe që sot janë të njohura për opinionin, për të cilat nuk kishte hasur në mirëkuptim nga kolegët dhe bashkëkohësit e tij, pse mos të besojmë se megjithatë diçka ka në këto përsiatje, pse apriori të kundërshtohen këto ide të reja shkencore?!

Zëri shkencor që nuk dëgjohej nga askush!

Në vitin 2002, një gazetë britanike shkruante, duke cituar një matematikan britanik, se ai ia ka dalë që ta zgjidhte një problem nga listat e Teorinë e Poincarit. Ai ishte i bindur se zgjidhja e tij ishte e mundur, por ai "nuk mund ta dëshmonte këtë matematikisht". Pra ky problem është shtruar që nga viti 1904 nga matematikanti francez Henri Poincaré, i cili bëri përpjekje për të gjetur mënyrën për kuptimin e elementeve të hapësirës tredimensionale, duke modifikuar kalkulimet e njohura deri atëherë rreth hapësirës dydimensionale. Pra, për këtë hipotezë një institut shkencor amerikan kishte afruar shumë të madhe për zbulimin e tillë, porse për këtë zbulim,

verifikimin e tij, duhet të pritët shumë vjet pas shqyrtimit të gjithmbarshëm ndërkombëtar. Në këtë drejtim, profesor Gjota thotë se e ka arritur zgjidhjen, por askush nuk e dëgjon zërin e tij.

A janë marrë seriozisht dhe a janë absorbuar këto ide të mëdha të Gjotës nga intelektualë dhe kuadro shkencorë të kohës? Përkundrazi. Ata madje e penguan me injorancën e tyre, e penguan me veprimet e tyre antishkencore, duke e përkufizuar shkencën si diçka të përfunduar dhe duke mos e thyer shabllonin në kokat e tyre, se ata që mendojnë e veprojnë shkencërisht duhet të jenë të huaj e jo shqiptarë. Sipas kësaj logjike, çdo qasje e re në shkencë, çdo shikim tjetërnëdryshe nga ndonjë shqiptar, apriori duhet të jenë



vetëm fjalë, vetëm mashtrim, sepse shqiptarët dhe shkencëtarët janë në diskrepancë të thellë. Kjo qasje e gabuar vazhdon të dominojë edhe më tej bindjen dhe kokat e intelektualëve shqiptarë, të profesorëve dhe të kuazishkencëtarëve.

Si duket, ne kemi prirje që t'u besojmë vetëm të huajve, jo atyre që flasin gjuhën tonë, që i kemi afër nesh...

Kush mund t'i përballonte gjithë këtë presion, gjithë kësaj sfide jetësore?! Vetëm ai që aq shumë beson në atë që e posedon, vetëm njeriu me moral të lartë shpirtëror e shkencor, njeriu i një profili dhe dimensionit të shkencëtarit të njëmendë siç i njeh historia. Në këtë dallë të presioneve, profesori nuk u ndal asnjëherë. Ai do të thoshte një thënie filozofike shumë domethënëse dhe që e mendonte seriozisht: "Nëse dikush më bind se unë nuk mendoj dhe veprojtë drejtë, do të isha i gëzuar dhe do të ndryshoja, sepse e

gjurmtoj të vërtetën prej së cilës njerëzimi nuk është lënduar kurrë".

Më 1994, Rifat Gjota prezantohet për herë të parë me "Sferizmin" në Pejë, Prishtinë, FSHMN, Fakultetin e Elektroteknikës, të Makinerisë, në Rektorat, Universitetin e Tetovës, në Gjilan, Kumanovë etj.

"E ndiej veten të lumtur e të nderuar. Në këto momente nuk e kam lehtë të flas për veten, sepse unë isha i mbyllur me dekada në kafaz. Unë u flijova për gjeneratat e ardhshme dhe ngado eca e shtegtova kërkova nektarin e diturisë. Ne do t'i japim shembull botës. Unë e gjeta atë çfarë njerëzimi deri tani nuk e ka parë. Unë nuk flas shumë, sepse, ku flet fakti nuk flet Rifati" - kishte thënë profesori në një prezantim të tij në Gjilan, më 12. 04. 2000.

Mendimet për Gjotën

Duke kombinuar njohuritë e përgjithshme nga matematika dhe fusha e motorëve, zbulimet e motorëve të Gjotës kishin gjetur edhe zbatimin praktik në shumë fabrika dhe korporata të atëherëshme në Kosovë, që nga viti 1987, si: në Separacionin e Kosovës B, në "Elektromont", në Fabrikën e Amortizatorëve" në Prishtinë, në Industrinë Minerale dhe të Magnezit në Golesh, në Organizatën Bazë të Letrës në Lipjan, në Fabrikat e Baterive në Pejë, Mitrovicë etj.

Puna e prof. Gjotës dhe kontributi i tij dhënë shkencës elektroteknike, u dekorua me shumë mirënjohje, shpërblime dhe medalje edhe në nivelin vendor por edhe ndërkombëtar.

Pikërisht për këtë studentët e profesor Gjotës ndihen krenarë për profesorin e tyre. Njëri ndër të diplomuarit nga fusha specialistike e inventive e profesor Gjotës është edhe Ylber Zabërgja nga Prishtina. "Prof. Rifat Gjota është një nga shkencëtarët e rrallë që arriti që problemin e fushave elektromagnetike rrotulluese, ta paraqesë në një formë më të avancuar që në praktikë paraqet një kursim apo zvogëlim të humbjeve të energjisë nga 10% deri në 30%, varësisht nga tipi, fuqia dhe nga destinimi

i makinave elektrike, gjegjësisht motorëve dhe gjeneratorëve elektrikë. Mënyra e qasjes së problemit nga Dr. Rifat Gjota qëndron, në esencë, në shtimin e një përshtjellje shtesë në motor, e cila është e çfazuara nga përshtjellja tjetër për 900. Ky është çfazim kohor 900 dhe çfazim hapsinor 900. Këtu edhe është ajo esencialja e tërë çështjes së makinave elektrike me fushë komplementare” - thotë z. Zabërgja. Ai pohon se praktika ka treguar se mënyra e re e përshtjelljes së makinave elektrike ka përparësitë e veta, që është e vërtetuar edhe teorikisht. Mënyra e qasjes së problemit nga prof. Rifat Gjota ka hapur një shteg ku duhet ende të punohet se kjo punë nuk ka përfunduar ende. Kjo çështje duhet të gjeneralizohet dhe mos të mbetet pa një shpjegim komplet teorik dhe praktik shkencor.

“Edhe pse bota prëndimore e ka pranuar këtë zbulim qysh në fillim të viteve 90-ta duke e dekoruar me medalje të shumta, ndërsa kuaziekspertët tanë të elektroteknikës shpresoj se më në fund do ta pranojnë këtë zbulim si vlerë të mirëfilltë kombëtare e intelektuale” - shprehet z. Zabërgja.

Të njëjtin mendim e kanë pothuajse të gjithë ish-studentët e Gjatës, të cilët shprehin shqetësim dhe zemërim për qasjen që ka pasur shoqëria dhe institucionet e Kosovës ndaj një shkencëtari i cili po të kishte përkrahje, do ta trondiste botën shkencore, jo vetëm me zbulimin paraprak, por edhe në matematikë. Këta studentë mendojnë se kjo qasje e shoqërisë dhe e institucioneve është tepër dekurajuese edhe për shkencëtarët e rinj, të cilët do ta kuptojnë ende pa ia filluar hulumtimeve të tyre se cili do të jetë fati i tyre në këtë shoqëri.

Ku dhe si jeton aktualisht profesor Gjota?

Menjëherë pas arritjes së moshës 65 vjeçare, strukturat udhëheqëse të fakultetit Teknik dhe Rektoratit të Prishtinës u ngutën për ta pensionuar profesor Gjatën, edhe pse ai duhet të ishte ende në stafin e mësimdhënësve të rëndësishëm dhe të ishte ende me studentët dhe me aktivitetet shkencore. Në këtë mënyrë, profesor Gjatën e nxorën edhe një herë nga loja në mënyrë ligjore ata të cilët, në forma të ndryshme, e kishin penguar në shtegtimin e tij drejt arritjeve kulmore në shkencë.

Me këtë veprim ata edhe e arritën qëllimin e tyre, sepse nuk ka më kush t’u krijojë shqetësime në shkencën e “përkryer e të përfunduar” nga të tjerët.

Profesor Gjota tashmë nuk jeton as në Prishtinë, por i është kthyer familjes së tij në Pejë dhe jeton me një pension prej 40, gjegjësisht 70 euro, si falënderim për gjithë atë sakrificë që ka bërë për shkencën, për të mirën e njerëzimit dhe për ardhmërinë e kombit. Është e qartë se tashti ai nuk i ka as kushtet minimale për jetë, e lere më të ndërmarrë diçka më shumë për jetësimin e ideve të tij shkencore, përkundër faktit se në kokën dhe në qenien e tij nuk janë shterur asnjëherë ndjenjat hulumtuuese dhe inventive për shkencën si një proces që nuk ka përfundim, nuk ka mbarim deri sa të ekzistojë njeriu. ■

Korrespondencë nga Shkupi

Ngritja dhe r

Anija e PDSH-së tani është çarë. Vrimën që mori guximin ta shpojë nënkryetari Ymer Selmani, vështirë se do të ketë forcë ta arnojë dikush në parti, sepse dallgët e dorëheqjeve vërshojnë degë e nëndegë... Tani në anijen e cila shkon drejt fundosjes ndodhen dy parti që s’bënë gjë për shqiptarët, pos për vete, anëtarët dhe disa simpatizantë të tyre



Avni AVDIU

Partia Demokratike Shqiptare fillimisht doli si fraksion i Partisë së Prosperitetit Demokratik, duke marrë madje edhe pjesë të emërimit të saj: Partia e Prosperitetit Demokratik Shqiptar. Ky emërtim ishte si kundërpërgjigje ndaj PPD-së e cila ndonëse kuptohej si parti e shqiptarëve, prapëseprapë nuk ishte deklaruar hapur si e tillë, bile në gjirin e saj kishte edhe anëtarë të nacionaliteteve të tjera jomaqedonase.

PPD-ja duke mbajtur qëndrim të butë ndaj pushtetit të atëherëshëm maqedonas dhe duke mos arritur t’i përmbushte kërkesat e shqiptarëve, filloi ta zbehë imazhin e saj si përfaqësuese e denjë e interesave kombëtare. Ishte momenti i volitshëm të krijohej fraksioni më radikal, i cili do të dëshmohej kombëtarisht më i vendosur, madje edhe me emërtim të qartë nacional. Në ballë të këtij fraksioni doli edhe figura karizmatike e Arbër Xhaferit, i cili dalëngadalë gjithnjë e më tepër profilizohej si politikan i pjekur. Pakkush mund ta ketë hetuar në fillim se Arbër Xhaferi vepronte nën tutelën e bashkëthemeluesit të fraksionit PPDSH-së, Menduh Thaçit, ose shprehur ndryshe Xhaferi ishte vetëm ana teorike e fraksionit, përderisa frerët në duar i kishte Thaçi, i cili ishte alfa dhe omega.

Me kalimin e kohës fraksioni PPDSH u zyrtarizua si PDSH dhe gjithnjë e më tepër shihej se nënkryetari Thaçi ishte më kryesor se sa kryetari Xhaferi, ndonëse rolet nuk ishin të tilla. PDSH-ja arriti të fitojë rejtingun e saj në saje të radikalizimit të kërkesave, veprimeve dhe paraqitjeve publike. Në kujtesën e opinionit shqiptar akoma janë të freskëta fjalimet brilante të deputetëve të kësaj partie në parlamentin maqedonas: Rufi Osmanit, Hysni Shaqirit dhe Sali Ramadanit. Në cilësinë e kryetarit të komunës së Gostivarit, në mbrojtje të flamurit shqiptar, Rufi Osmani u burgos dhe u dënua me 14 vjet burg, ndërsa popullata e cila kishte dalë në protesta paqësore u rrah në mënyrën më brutale. Ishin këto ngjarje që shtuan mllefën e shqiptarëve kundër pushtetarëve të LSDM-së dhe PPD-së, kurse PDSH-së ia shtuan rejtingun edhe më tepër.

PDSH-ja erdhi në pushtet me partnerin e koalicionit VMRO-DPMNE, duke liruar nga burgu prefektin Rufi Osmani. Megjithatë me të dalë nga burgu Osmani i akuzoi krerët e PDSH-së se ia kanë punuar mbas shpine dhe se e kanë vënë në pozitë viktimizuese për t’u ngritur mbi sakrificat e tij. Mirëpo fakti se PDSH-ja ishte në pushtet e futi nën hije pezmin e Osmanit dhe e mbante rejtingun e kësaj partie akoma të paprekshëm. Ishte lufta e Kosovës dhe menaxhimi i problemit me refugjatët, ato që PDSH-në e mbanin ende mirë.

ënia e PDSH-së

Gjatë periudhës së luftës PDSH-ja mbeti në pat-pozicion

Mirëpo më vonë u pa se PDSH-ja atë që kishte premtuar në fushata elektorale nuk e realizonte dot. Ajo ishte shndërruar në parti marketingu patriotik, më tepër parti propagandistike se sa parti pragmatike, më shumë deklarative se sa e mbajtjes së fjalës dhe premtimeve të dhëna. Zaten problemet e shumta të grumbulluara të popullatës shqiptare për të cilat kjo parti bëhej e shurdhër, plasën sherrin në Tanushë, ku edhe shpërthyen shkëndijat e para të luftës së armatosur të 2001-shit.

Gjatë periudhës së luftës kjo parti mbeti në pat-pozicion. Deklarata e nënkryetarit të qeverisë nga radhët e saj për luftëtarët e UÇK-së se qeni i keq e sjell ujkun në vathë, ishte skandaloze dhe shenjë e parë e fillimit të fundit të kësaj partie. Me mbarimin e luftës, PDSH-ja sërish bëri përpjekje të vetëfaktorizojë përpara opinionit shqiptar: si arkitekthe e Marrëveshjes së Ohrit.

Megjithatë dalja në skenë e Ali Ahmetit si zëri i parë i UÇK-së e minimizoi rolin e Arbër Xhaferit. Populli i dalë nga një luftë e përgjakshme ishte i prire skajshmërisht drejt frymës së luftës, e cila ndonëse kishte marrë fund përmes tytave, nuk kishte përfunduar në bisedat e përditshme. Dhe natyrshëm fitoi partia e formuar nga ish krerët e UÇK-së, duke e lënë PDSH-në në opozitë. Në ndërkohë PDSH-së i erdhi përfundim nga ish strukturat politike të UÇK-së. Bardhyl Mahmuti zhvilloi fushatë të egër kundrejt Ali Ahmetit, duke iu drejtuar me fjalët më të rënda degraduese. Mirëpo kjo nuk i ndihmoi që të ngritej në PDSH. Ombrella e Thaçit nuk linte të rritej kush tjetër në parti pos Arbër Xhaferit, i cili faktikisht ishte kukull e tij. BDI-ja e Ali Ahmetit gjatë bashkëqeverisjes katërvjeçare me LSDM nuk arriti ta lëvizte gurin e Marrëveshjes së Ohrit asnjë milimetër. Dhe kur pritej që populli ta ndëshkonte për këtë "paaftësi", ndodhi e kundërta: sërish populli ia dha votëbesimin, duke dashur t'i përcjellë mesazhin kësaj partie se beson në

frymën e saj, e cila ishte frymë e gjakut të dëshmorëve, jetimëve, invalidëve dhe shumë të përvuajturve nga lufta ende e freskët në kujtesë. Megjithëkëtë, PDSH-ja doli në pritë duke hyrë në qeveri edhe pse humbëse, me arsytimin se ishte e thirrur në bashkëqeverisje nga partneri tradicional VMRO-DPMNE-ja me të cilin i lidhte programi ideologjik. BDI-ja u ndie e tradhtuar nga ky veprim i PDSH-së dhe plot dy vjet u zhvillua luftë e vërtetë polemikash se cili kishte të drejtë të hynte në bashkëqeverisje. E ndier si faktore PDSH-ja nuk kishte edhe forcë morale të ishte zë i fuqishëm përballë VMRO-DPMNE-së në avancimin e çështjes shqiptare në Maqedoni. Mirëpo në një stil prej akrobatiku kryetari Thaçi i shtroi ultimatium kryeministrit Nikolla Gruevski prej gjashtë pikash, edhe atë mu para samitit të Nato-s në Bukuresht, ku duhej të vendosej për pranimin e vendit në Aleancën Veriatlantike. Kjo e irritoi kryeministrin maqedonas se pse aleati "ia gjeti ditën për t'ia nxjerrë dritën". Dhe realisht u krijua një ftohje e partnerëve bashkëqeverisës. Këtë e hetoi kryetari i BDI-së Ali Ahmeti, i cili nuk mund ta duronte PDSH-në në qeveri. Prandaj kërkoi zgjedhje të parakohshme parlamentare, duke qenë i bindur në fitore dhe rrjedhimisht në marrjen e pushtetit. Gruevski e hetonte se atij dhe partisë së tij po i rritej rejtingu për shkak të qëndrimit radikal ndaj kontestit me Greqinë, dhe ofertën e Ahmetit e mirëpriti: më mirë sigurt 4 vjet në pushtet se sa 2 sa kishin mbetur.

Po fundoset anija e PDSH-së

PDSH-ja meqë nuk kishte bërë gjë e kishte premtuar shumë gjatë dy vjet bashkëqeverisje me VMRO-DPMNE nuk gjente dot çelësin se si të arrinte përsëri në pushtet. Kësisoj në zgjedhjet e fundit bëri disa incidente, për të cilat në masë të madhe i ndihmoi edhe BDI-ja. Mirëpo gjuha dhe karakteri i fushatës së PDSH-së ishte shumë më i vrazhdë se sa i BDI-së. Në krah të përkrahjes së PDSH-së u vu edhe analisti i mirënjohur Janush Bugajski. Mirëpo qartë

shihej se PDSH-ja fundosej aq shumë në rejting sa që atë s'mund ta ndihmonte më askush. Pas shumë peripecive, votimeve dhe rivotimeve PDSH-ja u hodh detyrimisht në opozitë. Dhe zakonisht kur një parti është në opozitë gjasat për të plasur sherrin në radhët e anëtarëve të saj bëhen gjithnjë e më të mëdha. Tek më pas doli se paska pasur pakënaqësi të akumuluar, se disa anëtarë të saj s'qenkan pajtuar me menaxhimin e fushatës parazgjedhore, me politikat izoluese, me gjuhën e zënkave etj. Çudit fakti se pikërisht ato zëra të pakënaqur ishin ndër protagonistët kryesor të politikës së PDSH-së pas Thaçit dhe e mbështetën atë deri në pikën e fundit. Tashmë na doli se ata nuk po mundkan ta durojnë frymën diktatoriale të Thaçit, edhe pse s'dihet se si arritën ta duronin gjer më tani. Njëmend Thaçi ka qenë diktator, por sa meritore janë ata që tashmë dolën të pakënaqur, mbetet temë për diskutim më vete. Madje ata mund të llogariten edhe bashkëfajtorë për politikën konfliktuale të partisë. Pas publikimit të rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme kryetari i PPD-së Abdylhadi Vjeseli shprehu gatishmëri ta shkrijë partinë e tij në PDSH; edhe ashtu partia e tij u shkri nga mosvotimi i popullit, mbase nuk arriti të marrë asnjë mandat në zgjedhje.

Mirëpo anija e PDSH-së tani është çarë. Vrimën që mori guximin ta shpojë nënkryetari Ymer Selmani, vështirë se do të ketë forcë ta arnojë dikush në parti, sepse dallgët e dorëheqjeve vërshojnë degë e nëndegë dhe kjo ka marrë përmasa gjithnjë e më të mëdha. Tani në anijen e cila shkon drejt fundosjes ndodhen dy parti që s'bënë gjë për shqiptarët, pos për vete, anëtarët dhe disa simpatizantë të tyre. Kjo anije po fundoset, ndërsa emri i PPD-së dhe PDSH-së, si dy partive me gjenezë të përbashkët do të ngelë për një kohë të shkurtër vetëm në arkiva. ■



Me shkas

Viti i ri shkollor me probleme të vjetra

Është shqetësues fakti se në institucionet tona shkollore, veçmas në arsimin fillor dhe atë të mesëm, mësimdhënësit në të shumtën e rasteve mbajnë lëndët jo përkatëse, madje ka raste kur një arsimtar mban dy lëndë tërësisht të ndryshme, bie fjala matematikë dhe letërsi!



Fitim VELIU

Edhe në këtë fillimvit shkollor, mënyra e pranimit të punëtorëve të rinj nga ana e Drejtorive Komunale të Arsimit ka kaluar pothuajse si në vitet e kaluara. Ditari iu është besuar përsëri arsimtarëve që kanë punuar më herët pa u përfillur shumë kuadro të rinj të diplomuar në fakultetet përkatëse.

Ky avaz, për fat të keq, po përsëritet edhe në Kosovën e pavarur. Kjo si pasojë e mungesës së një infrastrukture ligjore e cila do t'i përcaktonte qartë kriteret e punësimit të arsimtarëve në nivelet përkatëse arsimore.

Ligji aktual, me gjasë, le hapësirë për t'u keqinterpretuar, ose nuk mund të zbatohet për shkak të ndikimit politik nga jashtë.

Është shqetësues fakti se në institucionet tona shkollore, veçmas në arsimin fillor dhe atë të mesëm, mësimdhënësit në të shumtën e rasteve mbajnë lëndët jo përkatëse, madje ka raste kur një ar-

simtar mban dy lëndë tërësisht të ndryshme, bie fjala matematikë dhe letërsi!

Ministria e Arsimit ka bërë përpjekje që ta rregullojë këtë kaos të krijuar nëpërmjet certifikimit të mësimdhënësve, por pothuajse ka dështuar në këtë drejtim. Shkak i dështimit ka qenë mos serioziteti i drejtuesve komunalë të arsimit të cilët nuk ua kanë mundësuar zyrtarëve të MASHT-it qasjen në dokumentet e mësimdhënësve, duke i fshehur në të shumtën e rasteve dosjet diskutabile të arsimtarëve.

Ka shumë raste kur për lëndë të caktuar të cilat i mbajnë punëtorë të pakualifikuar, nuk shpallet konkurs fare (fshehen orët) dhe me vite të tëra nuk shpallet vendi i punës, ndërkohë që të diplomuarit mbesin në rrugë duke u detyruar shpeshherë të merren edhe me punë krahu e t'i largohen jo vetëm profesionit, por edhe vendit të tyre për të siguruar ekzistencën. Paradoksi tjetër është se shumë nga punonjësit e arsimit të mesëm janë të padiplomuar dhe vendi i tyre i punës nuk shpallet i lirë, me arsyetim se ata gjoja kanë stazh të punës. Arsyetim tjetër i zyrtarëve komunalë të arsimit lidhur me këtë çështje është se "ka ardhur vendim nga Ministria e

Arsimit se duhet të kenë përparësi më të vjetrit!"

Paradoksi i tretë është se ligji në fuqi i diskriminon të sapodiplomuarit, sepse për t'u punësuar duhet të merret parasysh përvoja, trajnimet, ndërsa diploma nuk thekson ndonjë rol të madh.

Paradokse të tilla ka shumë në institucionet tona të dijes dhe nga kjo humbin të gjithë: shoqëria, nxënësit dhe e ardhmja.

Është momenti i fundit që MASH-ti ta definojë qartë statusin e secilit mësimdhënës. Atyre, të cilët për shkaqe të ndryshme e kanë ndërprerë fakultetin por ende punojnë në procesin mësimor, t'u jepet edhe një mundësi: ose ta përfundojnë ose të largohen nga arsimi. Gjithashtu, duhet të definohet qartë statusi i studentit i cili jep mësim. Nuk themi që atyre t'u mohohet e drejta e punës, por jo të jetë i privilegjuar në raport me të diplomuarin. Po ashtu, me rastin e pranimit të personelit mësimdhënës, MASH-ti duhet të formojë një komision i cili do të verifikonte, nëse konkursi ka qenë i rregullt ose jo, duke e shkurtuar kështu mundësinë e manipulimit të konkurseve nga ana e zyrtarëve komunalë të arsimit. ■

Kosova me shifra shqetësuese të analfabetizmit

Një raport i Kombeve të Bashkuara nxjerr të dhëna se Kosova ka rreth 10 për qind analfabetë të të gjitha moshave. Por përqindja më e madhe është tek femrat me rreth 80 për qind të këtij numri.



Vjollca SHEQIRI

Hajrullahu 46 vjeç, nga një fshat i Gollakut është njëri nga shumë analfabetët e Kosovës, i cili nuk di të shkruajë, e as të lexojë. Kur shkon për të nxjerrë ndonjë dokument, atij shpeshherë i nevojitet ndihma e dikujt tjetër, për të kryer punë. Ai e ka kuptuar se jeta është shumë e vështirë pa ditur shkrim e lexim dhe këtë e pohon pa kurrfarë kompleksi: “Une nuk di me shkru, e as me lexu, jam gjys njeri. As nuk di me percjell filma qa i qesin me germa, se nuk di me i lexu”, - thotë Hajrullahu, duke shtuar se edhe për të shkuar te mjeku duhet të marrë dikë me vete, pasi që nuk di t’i lexojë recetat.

“Me shku te doktori, duhet me marrë dikë që din me lexu edhe me shkru, sepse une nuk di, se kuptoj qka me thotë mjeku”, - thotë ai.

Hajrullahu fajëson institucionet e Kosovës për mosmarrje të iniciativave për zhdukjen e analfabetizmit. Madje dyzetegjashtëvjeçari fajëson edhe të gjithë shoqërinë e vetëdijshme për mosdhënien e ndihmës dhe përkrahjes për këta persona.

“Neve askush nuk na ndihmon, s’ka as qeveri e as drejtori në Kosovë, ata kqyrin veç qysh me u ba të pasun për vete, bile edhe fmija po qeshin me neve”, - thotë Hajrullahu. Ai e tregon një rast kur një qytetar ishte tallur me të, duke e dërguar në aeroport për të blerë disa barna: “Më dërgoi në aeroport me ble barna, më tha se s’ka tjetër kund barna të këtij lloji, e une se dija, e shkova”, - rrëfen ky fatkeq që sapo i ka mbushur 46 vjet.

Paçarizi: Mundësia e zhdukjes së analfabetizmit në Kosovë është e lehtë

Edhe sociologët shprehen të zhgënjyer me kujdesin që po tregojnë institucionet e vendit ndaj kësaj kategorie të njerëzve. Agim Paçarizi, sociolog, thotë se Kosova është shumë e vogël, andaj mundësia e zhdukjes së analfabetizmit është e lehtë.


“E gjithë shoqëria e Kosovës, duke përfshirë organet kompetente, ministrinë dhe drejtoritë e arsimit, duhet të merren seriozisht me këtë çështje shumë të rëndësishme”, - thotë Paçarizi, duke shtuar se duhet të gjenden mënyra stimuluese në drejtim të arritjes së suksesit, duke i përdorur ato që në moshën e re.

Nga ana tjetër, zyrtarë të ministrisë së arsimit shprehen se janë ndërmarrë të gjitha masat në luftimin e kësaj dukurie negative.

Sipas disa raporteve, Kosova radhitet në mesin e atyre vendeve me numër të madh të analfabetëve, me rreth 15-20 për qind.

Një raport i Kombeve të Bashkuara nxjerrë t dhëna se Kosova ka rreth 10 për qind analfabetë të të gjitha moshave. Por përqindja më e madhe është tek femrat me rreth 80 për qind të këtij numri.

Vendi me shkallën më të madhe të analfabetizmit në botë ka qenë Algjeria. Ajo, në vitin 1985, kishte rreth 50 për qind të popullsisë analfabete, por në vitin 2000, përqindja kishte rënë në 11.5 për qind. ■



Mbishkrim në “gjuhën kosovarçe” në një vitrinë në qendër të Prishtinës!

Foto: D.Reshiti

Solidariteti në vepër

“RAHMA MERCY” ndihmon 550 fëmijë jetimë të Skenderajt

“RAHMA MERCY” është një organizatë bamirëse me seli në Londër e cila që nga mbarimi i luftës ka hapur degën e saj në komunën e Skenderajt, përkatësisht në fshatin Morinë. Kjo organizatë përkujdeset për 550 fëmijë jetimë të cilëve krahas kujdesit psikosocial, ju ofron edhe nga 25 euro në muaj ndihmë financiare që nga viti 2003.



Arber ZEKA

Komuna e Skenderajt radhitet ndër komunat më të varfra të Kosovës. Kjo komunë siç dihet është ndër më të dëmtuarat nga lufta si në aspektin njerëzor, ashtu edhe atë material.

Ndonëse kanë kaluar nëntë vite nga përfundimi i luftës, ka njerëz që edhe sot jetojnë në gërmadhat e shtëpive të shkatërruara. Një pjesë e të pastrehëve, janë sistemuar në konviktin e gjimnazit të Skenderajt, afër stacionit policor të këtij qyteti. Jeta në këtë konvikt pasqyron realitetin e njerëzve të vuajtur të kësaj komune të cilët janë lodhur nga skamja. Vende të tilla me njerëz që kanë ngelur nën mëshirën e fatit ka edhe në shumë fshatra të kësaj komune.

“RAHMA MERCY” është një organizatë bamirëse me seli në Londër e cila që nga mbarimi i luftës ka hapur degën e saj në komunën e Skenderajt, përkatësisht në fshatin Morinë. Kjo është njëra nga shumë organizatat humanitare që

po japin kontributin e tyre në zbutjen e varfërisë në këtë komunë.

Kjo organizatë përkujdeset për 550 fëmijë jetimë të cilëve krahas kujdesit psikosocial, ju ofron edhe nga 25 euro në muaj ndihmë financiare që nga viti 2003.

Drejtori i kësaj shoqate, Xhemajl Duka, thekson se kjo ndihmë financiare, edhe pse simbolike, është shumë e mirëseardhur për këta fëmijë jetimë sepse shumica prej tyre po përballen me kushte të rënda ekzistenciale. Sipas z. Duka, krahas trajtimit financiar shoqata ndan për këta jetimë edhe ndihma të tjera në ushqim, veshmbathje, mjete mësimore etj.

Një mijë pako ushqimore për skamnorët..

Lutfije Uka, një nënë nga fshati Gradic, afër maleve të Qyqavicës, është njëra nga përfitueset e ndihmave të kësaj shoqate. Ajo përkujdeset për 6 vajza e 3 djem jetimë dhe shprehet mirënjohëse për ndihmat që merr nga kjo organizatë. “Si kryefamiljare nuk është lehtë të rritësh jetima, e aq ma vështir kur 9 fëmijë, kërkojnë shkollim, më i ushqy, e këtë duhet të bëjë një grua e vetme e shtyrë në moshë”, - shprehet nënë Lutfija.

Projekti për jetimët nuk është i vetmi projekt i shoqatës “RAHMA MERCY”.

Drejtori Duka, thekson se prioritetet u është dhënë edhe ndërtimit të disa puseve për ujë: “Në këto anë kemi shumë fshatra të cilat kanë probleme të mëdha me ujën. Rezalla, Likofci, Tica etj. janë disa nga fshatrat ku ne si shoqatë kemi hapur puse në mënyrë që t’u ndihmohet atyre që kanë nevojë, edhe pse kjo nuk ka qenë fare e lehtë, duke marrë parasysh pozitën gjeografike të këtyre fshatrave”, - është shprehur drejtori i “RAHMA MERCY” në Skenderaj.

Në fillim të muajit të Ramazanit, kjo shoqatë ka shpërndarë mbi një mijë pako ushqimore për skamnorët e kësaj ane, në mënyrë që së paku në këtë muaj të shenjtë ata të kenë çfarë të shtrojnë për iftar e syfyer në sofrat e tyre.

“Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ka thënë: Kush nuk mëshiron nuk do të mëshirohet”. Më këto fjalë drejtori i shoqatës “RAHMA MERCY” arsyeton projektet e realizuara deri më tani dhe u bën thirrje edhe të tjerëve që të solidarizohen me ata që kanë nevojë. ■



Gratë e Kodrës së Minatorëve vazhdojnë fqinjësinë e mirë ndërmjet tyre

Shembull se si mund të bashkëjetohet

Në kuadër të aktiviteteve të Qendrës, gjatë muajve të fundit, dhjetëra gra të lagjes kanë vizituar objektet kulturore dhe trashëgimore, në Prizren, në fshatin Boletin të komunës së Zveqanit, në kullat e Isniqit të Deçanit dhe në Grykën e Rugovës



Florije ADEMI

Tash katër vite në lagjen veriore të banuar me popullatë të përzier, "Kodra e Minatorëve", funksionon qendra e grave, e hapur nga organizata joqeveritare Community Building Mitrovica (Ndërtimi i Komuniteteve në Mitrovicë)-CBM.

Në këtë qendër, tri herë brenda javës tubohen të rejtat dhe gratë e komuniteteve të ndryshme që banojnë në këtë lagje, por edhe jashtë saj.

Ndonëse për shkak të situatës politike dhe asaj të sigurisë që mbizotëron në qytetin buzë Ibrit, bashkëjetesa nuk zhvillohet sikurse para lufte, kjo qendër u mundëson këtyre grave që të takohen dhe t'i "qajnë" hallet e tyre.

Ato pranojnë se nuk pas probleme ndërmjet tyre, por situata e përgjithshme ka ndikuar në largimin e tyre për një kohë.

"Që nga fillimi i punës, unë vij rregullisht në qendër dhe kaloj shumë mirë me të gjitha gratë që vijnë këtu" - thotë Stanka Gjuriq, pjesëtare e komunitetit serb, duke shtuar se "prej luftës, nuk kam mundur më të shoqërohem me fqinjat e mia shqiptare si më parë, për shkak se gjendja ka qenë kësajsoj, por publikisht them se unë nuk kam pas kurrë as më të voglin problem nga fqinjët e mi shqiptarë e as të komuniteteve të tjera".

Gjuriq është e mendimit se një qendër e tillë, ku gratë mund të vijnë të takohen dhe të bisedojnë për çështje të ndryshme, duke lënë anash politikën, ka qenë më se e nevojshme.

Vatovci: Shqiptarët nuk kanë pasur arsye t'i shisinin pronat

Edhe Sevdije Vatovci, shqiptare, pohon se asnjëherë s'ka pasur problem me serbët vendor të lagjes, por shprehet e rezervuar për ardhacakët që janë vendosur në lagje pas shitjes së dhjetëra pronave nga shqiptarët.

Sipas saj, shqiptarët nuk kanë pasur arsye t'i shisinin pronat e tyre. Megjithatë, ajo pranon se brenda lagjes ka siguri, por jo edhe jashtë saj.

Ajo akuzon Qeverinë e Kosovës që nuk u ka ndihmuar kurrë në asnjë aspekt këtyre banorëve, duke e ditur se janë të mbyllur në lagje. Një akuzë e tillë shkon edhe për pushtetin lokal, partitë politike, të cilat sipas saj shkojnë në lagje vetëm në prag të zgjedhjeve.

Shehribane Kuqi, e cila është pjesëmarrëse e rregullt në takimet e grave që mbahen në këtë qendër, thotë se jeton me vite në këtë lagje dhe asnjëherë s'ka pasur problem nga fqinjët e saj, prandaj thekson se nuk ka ndërmend që të zhvendoset nga aty, vetëm nëse largohen të gjithë shqiptarët.

Këtë qendër e frekuentojnë edhe banoret të lagjeve në afërsi. Ivanka Millutinoviç, aktualisht banore e lagjes së spitalit, thotë se këtu ka gjetur një shoqëri të mirë dhe vjen me shumë kënaqësi ditëve të punës së qendrës.

Menaxherja e qendrës në fjalë është Vetone Velu, e cila shtëpinë e saj e ka shndërruar në qendër, ndërkaq, me gratë dhe fëmijët e lagjes punojnë Gëzime Pllana dhe Myzefa Tërziq.

Sipas tyre, në qendër gravitojnë rreth 100 gra të "Kodrës së Minatorëve", "Lagjes së spitalit" dhe lokalitetit të ashtuquajtur "Te Polieti". Shumica e tyre janë banoret të përhershme të këtyre lagjeve, por ka edhe të tilla që janë refugjate serbe të ardhura nga qendra të tjera të Kosovës.

Ato zhvillojnë aktivitete të ndryshme. Disa herë janë organizuar edhe ligjërata për vetëdijesimin e grave në lidhje me sëmundjet e ndryshme.

Në këtë qendër ato festojnë çdo festë të tyre, dëgjojnë muzikë, vallëzojnë bashkërisht dhe asnjëherë prej pjesëmarrësve nuk i pengon vallja apo muzika e komunitetit tjetër.



Gjatë trajnimit

Ekursionet multietnike

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, tensionimi i situatës e “bllokoi” për dy javë punën e qendrës, por pas kësaj periudhe ato vazhduan takimet e tyre sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ndonëse jashtë lagjes gjendja e sigurisë ishte e tensionuar, në lagje mbretëronte një atmosferë e qetë dhe tolerante.

“Ne jemi mësuar tani që të tubohemi dhe të bisedojmë për gjëra të ndryshme në këtë qendër, dhe mosfunksioni i saj dy javë me të vërtet na ka munguar” - thotë Hanëmshahe Hyseni.

Në kuadër të aktiviteteve të Qendrës, gjatë muajve të fundit, dhjetëra gra të lagjes kanë vizituar objektet kulturore dhe trashëgimore, si në Prizren, ku kanë vizituar xhaminë, kishën katolike, atë ortodokse dhe hamamin, pastaj në fshatin Boletin të komunës së Zveqanit kanë vizituar dy objektet trashëgimore, kullën e heroit kombëtar Isa Boletini dhe manastirin, kullat e Isniqit të Deçanit dhe më pas Grykën e Rugovës.

“Është me rëndësi të thuhet katër herë, gratë e komuniteteve të ndryshme kanë udhëtuar bashkërisht me autobus nga ura e Ibrit dhe në të gjitha këto aktivitete ato janë shprehur të kënaqura se kanë pasur mundësinë t’i vizitojnë këto objekte që deri më tani nuk ua ka ofruar dikush tjetër” - thotë koordinatoresha Vetone Veliu.

Këto vizita multietnike janë bërë në kuadër të projektit “Çka gratë dëshirojnë”, përkrahur nga UNIFEM-i.

Qendra e gruas në “Kodrën e Minatorëve” funksionon nga shtatori i vitit 2004, me përkrahjen e organizatës joqeveritare Community Building Mitrovica-CBM si dhe donatorëve të kohëpaskohshëm, ku dy vitet e fundit (2007/08) përkrahjet edhe nga organizata ndërkombëtare Mennonite Central Committee-MCC.



“Tregtarët” e

“Tregtarët” e fesë, siç kam parapëlqyer t’i quaj unë të konvertuarit e Kosovës, veçanërisht “muslimanët” e fshatrave Kravesari dhe Llapushnik, nuk kanë as ndjenjën më të vogël të të qenit besimtar.



Emine A. VEZAJ

Shqiptarët, ashtu sikurse edhe popujt e tjerë të botës, kanë fetë të tyre, atdheun, kombin, gjuhën dhe historinë e tyre. Për shkak të pozitës strategjike të vendit të tyre, si urë që lidh Lindjen me Perëndimin, nëpër trojet shqiptare gjatë historisë kanë kaluar shumë ushtri të perandorive të ndryshme. Për këtë ata pësuan edhe në aspektin kombëtar, fetar e kulturor.

Ashtu siç na mëson historia, të parët tanë në aspektin fetar kaluan nga paganizmi në krishterim dhe, më në fund, në islamizëm, kështu që në kohën e sotme, shumica dërmuese e shqiptarëve i përkasin fesë islame dhe pjesa tjetër asaj të krishterë me dy ritet, atij lindor - ortodoks dhe atij perëndimor - katolik.

Siç ka theksuar mr. Qemajl Morina, në artikullin e titulluar “Mbi fenë, atdheun dhe kombin”, falë vetëdijes së tyre të lartë, si edhe interpretimit të drejtë të misionit të fesë nga ana e prijësve fetarë, ndër shqiptarë nuk pati asnjëherë përçarje në baza fetare. Secili prej tyre, me liri të plotë, e predikonte dhe e praktikonte fenë e vet, e kur atdheut i kanosej rreziku nga armiqtë e jashtëm, ata të gjithë ishin unik në mbrojtje.

Heshtja apo indiferenca na bënë përgjegjës para të ardhmes

Të tri fetë të cilat sot janë aktuale, gjithëherë janë konsideruar si një shtyllë e fortë që ka ndihmuar mbijetesën ndaj çdo sunduesi apo tirani. Shembuj të tillë kemi kur feja krishtere ka ndihmuar mbijetesën në lashtësinë romake, ortodoksizmi në atë bizantine, si dhe feja islame që konsiderohet një shtyllë shumë e fortë e mbijetesës së shqiptarëve nga

asimilimi latin, grek e sllav. Kjo formulë e koekzistencës në mes feve mund të konsiderohet si një lidhje e fortë e cila krahas besimit lidhet edhe me atdhetarizmin, por më shumë edhe si një lidhje bashkëjetese më fqinj në rrethane lufte dhe paqeje.

Kohëve të fundit janë të shpeshta pohimet, si dhe raportet në gazeta të ndryshme ditore, rreth një rikthimi në “fenë e të parëve” nga disa të ashtuquajtur “muslimanë”. Këto raste ndoshta do të duheshin të mbeteshin si ‘pa koment’, por në këtë rast, seç më shkoi në mend një thënie e Hugos: “Shpeshherë të folurit është vepër, ndërsa heshtja është krim”. Që të mos e zgjas më shumë në këtë hyrje, do të doja të futem në temë. Sot, më shumë se kurrë ka shumë gjëra për të cilat duhet të flitet, të sanksionohen, të ndalohen, të dënohen sa s’ka ku të vejë më tej, andaj heshtja apo qëndrimi indiferent ndaj këtyre dukurive, na bën përgjegjës para të ardhmes.

Flitet shumë, debatohet pafundësisht, trillohen të qena e të paqena, të gjitha



fesë – të konvertuarit

këto rreth një identiteti të mirëfilltë musliman – katolik apo edhe ortodoks.

Pirro Prifti në një analizë me titull “Ri-konvertimi në fenë e të parëve, një opsion i nevojshëm”, të bërë kohë më parë, konstaton se “konvertimet e kosovarëve në fenë e të parëve janë një ogur i mirë sepse krahas bërjes së shtetit të Kosovës sovran dhe të pavarur po përm-bushet edhe shtylla e dytë – feja... shtyllë të cilën shqiptarët e kanë patur të dëm-tuar qëllimisht nga pushtuesi turk, (duke mos i hyrë debatit që manipulohet nga disa radikalistë islamikë, kur thonë se... feja myslimane e ka ruajtur identitetin e shqiptarëve të Kosovës.. , që në fakt është një absurd i qëllimshëm)”. E çuditshme! Si një analizë e tillë nga Prifti, unë me shumë dëshirë do të doja të merrja një përgjigje të një pyetje të tillë të dalë nga leximi i analizës së tij, se kush do të vinte për- para feja ose atdheu??? Pasi është shumë e logjikshme, m b a s e edhe e padiskutueshme, se njerëzit janë ata që e krijojnë kombin dhe janë kontribuues në të, ndërsa feja – besimi, është ndjenjë e lindur, që është rrjedhojë e lindjes së tij, dhe varësisht edu- k a t e s nga e cila formë-

sohet individ, ai edhe zgjedh besimin e tij. Binomi i tij (Pirro) Shtet= Fe + Atdhe, do të dështonte në matematikë në konkurrim edhe me ata që e njohin shumë pak këtë fushë.

Rikthimi në një besim të mëparshëm, shqiptarët do t'i lidhte me paganizëm

Seç kam një energji të shkruaj e të shkruaj për këtë temë, aq kam energji për të paraqitur një realitet tejet të hidhur të të konvertuarve. Jo rastësisht shkrimit tim të sotëm, i vura emrin “Tregtarët” e fesë – të konvertuarit”. Aq shumë është shkruar për identitetin shqiptar, sa që nuk e di nëse do të duhej të interesoheshin aq shumë për një popull aq të vogël, por me histori të gjatë. Vet përpilimi i një fraze “tregtar” të fesë - çdonjërit do t'i binte në sy. Nëse do të duhej të jepej një sqarim më në detaje rreth këtij formulimi, sigurisht se të gjithë do ta kuptonim më mirë. Feja – besimi, është e drejtë personale e individit dhe ai mund të vendos vetë se cilit besim dëshiron t'i përkasë. Liria e besimit në kohët moderne është e garantuar në të gjithë botën dhe në të gjitha kushtetutat e cilitdo shtet qofshin. Fakti i hidhur i një “imponim” të besimit islam tek shqiptarët në periudha të ndryshme kohore, veçmas gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, sikur na bën përgjegjës për një studim më serioz dhe më objektiv rreth asaj periudhe, madje edhe citimet e Pirro Priftit dhe shumë studiuësve të tjerë të llojit të tij, na bëjnë edhe më shumë përgjegjës për një paraqitje të një realiteti pak më ndryshe, krahasuar me këta të fundit.

“Tregtarët” e fesë, siç kam parapëlqyer t'i quaj unë të konvertuarit e Kosovës, veçanërisht “muslimanët” e fshatrave Kravesari dhe Llapushnik, nuk kanë as ndjenjën më të vogël të të qenit besimtar. Besimi tek një person përfitohet me të qenit i vetëdijshëm për ekzistencën e çfarëdo qoftë ajo. P.sh. një produkt i marrë në ndonjë dyqan dhe i cili është i pëlqyer, ai do të mbetet edhe më tej i këndshëm për mua, sado që të tjerët do të thoshin se për këtë ose atë arsye ai mund të jetë jo i mirë, por besimi im në të qenit e produktit si i shkëlqyer për

mua, nuk do të më ndalonte ta përdorja pavarësisht nga kritikrat e të tjerëve. Në këtë rast, besimi në Krijuesin fitohet vetëm atëherë kur bindesh se ai është Krijues dhe Mbikëqyrës i çdo gjëje që ekziston. Vetëm atëherë kur zemra dhe mendja frymojnë lirshëm nga një e tillë bindje. Të qenit besimtar nuk është formë e imponimit, madje në një rast të tillë ajo nuk do të quhej besim, por do të merrte formën ose trajtën e dhunës ose imponimit.

Rikthimi në një besim të mëparshëm, e që tek shqiptarët anamneza do t'i lidhte me një besim pagan, sërish do të hidhte poshtë teorinë e të konvertuarve në një besim “të pastër”. Së këndejmi, nëse besimi i tyre i deritanishëm ka qenë zgjidhje e vetme për t'iu shmangur një shkrirjeje ose një asimilimi të pushtimit osman, për mendimin tim, qysh moti do të duhej që këta të konvertuar të riktheheshin në fenë e të parëve, e jo të prisnin momentin e tanishëm, pasi Kosova ka kohë që nuk është pjesë e atij “sundimi” osman. P.sh, më 31 Janar 1946, kur Kosova mbeti nën Serbi dhe kur atëherë u shënua edhe fundi i Luftës së Dytë Botërore, më pastaj në vitet 1950 kur u bë dëbimi masiv i më shumë se 230 mijë shqiptarëve në Turqi, një spastrim etnik që kishte rrënjët në teoritë raciste të Vaso Çubrilloviçit, do t'i shkonte më për shtat të konvertuarve të tanishëm ajo periudhë, pasi të gjitha dëbimet që janë bërë nuk kanë qenë për të krishterët shqiptarë, por kanë qenë muslimanët e mjerë që gjithmonë i kanë kontribuar atdheut të tyre në çfarëdo forme të mundshme, mbase edhe konvertimet e këtyre të “krishterëve” të sotëm, në atë kohë do të ishin më të mirësëardhura, sado që ata do të ishin të ndarë në bindjet e tyre në të krishterë – ortodoks, ata janë të një gjeneze. Besimi i këtyre të tanishmëve dhe gjoja e një rikthimi në natyrshmërinë e tyre, më kujton rëndom tregtinë e këtyre të mjerëve që bëjnë me besimin e tyre. Mjerë për ata që shfrytëzojnë besimin për të fituar pozita ose të mira të ndryshme materiale. Nuk i dihet, ndoshta (mos dhashë Zoti) që Kosova të mbikëqyret edhe nga ndonjë pushtues tjetër, me siguri të tillët, do të kalojnë edhe në ndonjë fe para të parëve të tyre. ■



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Demir RESHITI

Gjatë muajit korrik nuk ka pasur asnjë njohje ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, ndërsa në muajin gusht, Kosovën e kanë njohur Malta, Kolumbia dhe Belize.

Nga mesi i korrikut, shefi i OKB-së Ban Ki Moon, e ka urdhëruar përfaqësuesin e tij në Kosovë që të nisë rikonfigurimin e UNMIK-ut, ndërsa më 18 korrik, në Bruksel, janë mbledhur përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, të NATO-s, të OKB-së dhe të OSBE-së, për të diskutuar për përcaktimin e bashkëpunimit të të gjithë faktorëve ndërkombëtarë në Kosovë, e veçanërisht të KFOR-it, UNMIK-ut të rikonfiguruar dhe misionit në përgatitje EULEX.

Ndërkohë, për Kosovën është mbajtur një seancë edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në të cilën është diskutuar për raportin e kreut të OKB-së Ban Ki Moon për gjendjen në Kosovë.

Vlen për t'u theksuar edhe paralajmërimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar për nisjen e procedurave për anëtarësimin e Kosovës.

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajve korrik dhe gusht 2008.

(1 korrik) OSBE-ja mbështet institucionet e Kosovës

Astana - OSBE ka shprehur mbështetjen e saj për forcimin e institucioneve demokratike në Kosovë. Këtë e ka konfirmuar sekretari i përgjithshëm i kësaj organizate, Mark Perin de Brishambo, në mbledhjen e Asamblesë Parlamentare të OSBE së, në Astana të Kazakistanit.

(2 korrik) Çekia vendos marrëdhënie diplomatike me Kosovën

Pragë - Shefi i diplomacisë çeke, Karel Shvarcemberg e ka njoftuar përmes një letre presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu, për vendosjen e marrëdhënieve të plota diplomatike në mes të Republikës Çeke dhe Republikës së Kosovës.

(3 korrik) Frid: SHBA-ja e kënaqur me përparimin e bërë në Kosovë

Uashington - Shtetet e Bashkuara janë të kënaqura me përparimin e bërë

Tri njohje gjat



Daniel Fried

në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë në muajin shkurt, tha ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Çështjet Evropiane, Daniel Fried.

(8 korrik) Stanishev: Serbia e ka humbur Kosovën, politikanët serbë duhet ta kuptojnë këtë

Athinë - "Kosova de facto është e humbur për politikanët serbë dhe ata duhet ta kuptojnë këtë. Udhëheqësi serb duhet ta ndihmojë Kosovën në ndërtimin e ekonomisë funksionale të tregut, të zhvillojë marrëdhënie të mira dhe t'i mbrojë pakicat", - ka thënë Kryeministri i Bullgarisë, Sergei Stanishev në një intervistë dhënë gazetës greke "Imerisia".



Nikola Sarkozy

(10 korrik) Sarkozy: Kosova ka arritur përparim domethënës pas pavarësisë

Bruksel - Presidenti francez, Nikola Sarkozy, vendi i të cilit udhëhoq Presidencën e radhës të BE-së, duke folur në Parlamentin Evropian, ka thënë se Kosova ka arritur përparim domethënës pas pavarësisë, edhe pse nuk mund të themi se gjithçka është mirë.

(11 korrik) Polt: Pavarësia e Kosovës është fakt me të cilin Serbia duhet të mësohet

Uashington - Ish-ambasadori amerikan në Beograd Majkell Polt, ka thënë se pavarësia e Kosovës është fakt me të cilin Serbia duhet të mësohet sepse nuk ka kthim në gjendjen e mëparshme. "Serbia në këtë aspekt mund të luajë një rol shumë konstruktiv, jo vetëm në emër të serbëve që jetojnë në Kosovë dhe serbëve në përgjithësi, por edhe për vetë Kosovën dhe rajonin e gjerë", - ka thënë për "Zërin e Amerikës", Majkell Polt, i cili tani është këshilltar i lartë në Fondin gjerman Marshall në Uashington.

(14 korrik) NATO konfirmon mbështetjen për krijimin e FSK-së

Bruksel - Ministri i Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s në një takim dyditor në Bruksel, kanë konfirmuar mbështetjen që do të japë Aleanca në ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

"NATO do të mbikëqyrë shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës", - ka thënë Xhejms Apaturaj, zëdhënës i NATO-s.



Fondi Monetar Ndërkombëtar

(15 korrik) FMN njehtet Kosovën, nisin shpejt procedurat e anëtarësimin

Uashington - Fondi Monetar Ndërkombëtar paralajmëron nisjen e procedurave për anëtarësimin e Kosovës. Sektori ligjor i Fondit Monetar Ndërkombëtar ka konstatuar se Kosova është e pavarur dhe se vendimet e OKB-së dhe mosanëtarësimi nuk janë kusht për praninë në këtë organizatë. Këtë njoftim e ka bërë Banka Qendrore e Serbisë, duke u bazuar në mbledhjen e Bordit të FMN-së, të mbajtur më 14 korrik.

ë muajit gusht

(16 korrik) Kushner: Nuk ka ndarje të Kosovës

Bruksel - "Nuk do të ketë ndarje të Kosovës", - u tha gazetarëve shefi i diplomacisë franceze, Bernard Kushner, gjatë një fjalimi në Komitetin për politikë të jashtme të Parlamentit Evropian në Bruksel.



Ban Ki Moon

(18 korrik) Ban Ki Moon e ka urdhëruar Zanierin që të nisë rikonfigurimin e UNMIK-ut

Nju Jork - "I kam dhënë instruksione UNMIK-ut që të bashkëpunojë me Bashkimin Evropian me qëllim që të mundësojë që BE-ja të marrë rol të forcuar operacional në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara", - ka deklaruar sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon.

(18 korrik) Mbahet takim i përfaqësuesve ndërkombëtarë për Kosovën

Bruksel- Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, të NATO-s, të OKB-së dhe të OSBE-së, janë mbledhur në Bruksel, për të diskutuar për përcaktimin e bashkëpunimit të të gjithë faktorëve ndërkombëtarë në Kosovë, e veçanërisht të KFOR-it, UNMIK-ut të rikonfiguruar dhe misionit në përgatitje EULEX.

(25 korrik) Këshilli i Sigurimit ka diskutuar për Kosovën

Nju Jork - Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka diskutuar për raportin e kreu të OKB-së, Ban Ki Moon-it, për gjendjen në Kosovë. Raporti është përqendruar në procesin e rikonfigurimit të misionit të UNMIK-ut dhe zhvillimeve që i kanë paraprirë këtij procesi.

Shefi i UNMIK-ut, Lamberto Zanier,


ka thënë në Këshillin e Sigurimit se hyrja në fuqi e Kushtetutës së Kosovës, më 15 qershor, ka pamundësuar ushtrimin e misionit të administratës së OKB-së. Kosova në këtë takim është përfaqësuar nga ministri i Jashtëm, Skënder Hyseni.

Gjatë fjalimeve të tyre, shumica e ambasadorëve kanë përgëzuar arritjet në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë dhe kanë mbështetur planin për rikonfigurimin e UNMIK-ut.

(7 gusht) Kolumbia dhe Belize kanë njohur pavarësinë e Kosovës

Bogota, Belmopan - Kolumbia ka njohur zyrtarisht pavarësinë e Kosovës. Vendimi për njohje është kumtuar nga Ministra e Jashtme e këtij vendi. Në deklaratën e kësaj ministrie thuhet se Kolumbia e njeh Republikën e Kosovës shtet të pavarur e sovran, me synimin që të vendosë marrëdhënie diplomatike.

Ndërkaq Qeveria e Belizesë, në Amerikën Qendrore, i ka dërguar presidentit të Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiut, letërën zyrtare të njohjes së shtetit.



Malta

(21 gusht) Malta ka njohur Republikën e Kosovës

Valetta - Shteti i Maltës e ka njohur edhe formalisht Republikën e Kosovës si shtet të pavarur, duke u bërë kështu shteti i 21-të i BE-së që ka njohur vendin tonë. Lajmi është bërë i ditur nga Departamenti i Informacionit i Maltës. Ministri i Punëve të Jashtme të Maltës, Tonio Borg, ka thënë se Kosova njihet si shtet ngase nuk ka pasur alternativë tjetër për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur në 10 vitet e kaluara, bën të ditur "Times of Malta".

(27 gusht) Khalilzad: Mos e krahasoni Kosovën me Osetinë dhe Abkhazinë

Vjenë - Ambasadori amerikan në OKB, Zalmay Khalilzad, ka thënë se janë krejt të ndryshme rrethanat në Kosovë me ato në Oseti dhe Abkhazi.

"Në rastin e Kosovës pavarësia ka qenë një rrugë e gjatë që nuk mund të krahasohet me rajonet e Gjeorgjisë. Në Kosovë trupat serbe kanë kryer spastrim etnik, që ka çuar në intervenimin e NATO-s ndaj Serbisë dhe deri te pasojat ndërkombëtare", - ka thënë Khalilzad për gazetën vjeneze "Die Presse".



OKB

(28 gusht) OKB hedh poshtë paralelen midis Kosovës dhe provincave gjeorgjiane

Nju Jork - Organizata e Kombeve të Bashkuara hedh poshtë paralelen e Kosovës me dy provincat gjeorgjiane. Zëdhënësja e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Mishel Montas, ka thënë se të dyja situatat janë të ndryshme dhe krahasimet nuk qëndrojnë. "Mendoj se ju nuk duhet t'i krahasoni të dyja situatat. Historia e të dyja situatave është e ndryshme dhe mendoj se kjo është theksuar disa herë me radhë", - është shprehur zëdhënësja e Ban Ki Moon-it.

(28 gusht) Rupel: Rezistenca ndaj pavarësisë së Kosovës e përkohshme

Vjenë - Shefi i diplomacisë sllovene, Dimitrij Rupel, ka vlerësuar se çështja e Kosovës nuk mund të vihet në lidhje me Osetinë e Jugut dhe Abkhazinë, ndërsa rezistenca e disa shteteve në BE, ndaj pavarësisë së Kosovës, është vetëm e përkohshme.

"Besoj se rezistenca është vetëm e përkohshme", - ka thënë Rupel në një intervistë për agjencinë austriake të lajmeve APA, duke vlerësuar se kjo rezistencë do të zhduket kur Kosova të jetë e gatshme të hyjë në BE. ■

Histori Islame (22)

Të dërguam për mbarë njerëzimin

Muhammedi s.a.v.s. është shembull për ne. Ai nuk la trashëgimtar e as nuk e zgjodhi ndokënd ta drejtonte shtetin e ri. Në fakt, ai kishte dhënë shenjat dhe pëlqimin e tij, por asnjëherë nuk e shpalli për zëvendës askënd prej bashkëveprimtarëve të tij. Ai ishte i pazëvendësueshëm, prandaj këtë vendim ia la që ta zgjidhte vetë populli. Kështu për herë të parë në historinë e njerëzimit mësojmë se udhëheqësi duhet të zgjidhet nga populli dhe pa imponime.



Muhamed JUSUFI
-KAJOLLI

Në temën e kaluar vërejtëm se Muhammedi s.a.v.s. ishte bartës i tri paraqitjeve përpara publikut. Që të gjitha këto paraqitje ishin me shkrim. Paraqitja e parë ishte me Kur'anin, ndërsa në të dytën kemi hadithet e shenjta- kudsijje, kurse në paraqitjen e tretë kemi këshillat dhe vetë jetën e tij.

Në esencë të dërguarit e All-llahut janë të pagabueshëm dhe mbeten të tillë deri në përfundimin e jetës së tyre. Ata nuk dallojnë nga njerëzit e tjerë në aspektin fizik dhe në këtë pikëpamje ata janë që të gjithë si ne, por ajo që i bën të dallueshëm nga ne është se ata janë bartësit e mesazhit hyjnor, prandaj ata duhej të ishin të pagabueshëm në misionin e tyre. Kështu që njerëzimi duhet ta ketë të qartë se çdo gjë që vjen nga Krijuesi duhet të merret si aksiomë, sepse vargjet-ajetet janë të pandryshueshme dhe që të gjitha në esencë janë për të mirën e njerëzimit.

Në syrin e orientalistëve dhe historianëve

Studiuesit e orientalistikës duke pasur për qëllim ta njollosin Muhammedin s.a.v.s. Ata janë përpjekur të gjejnë qoftë edhe gabimin më të vogël në Kur'an. Gjatë punës së tyre të gjatë disa shekulle, ata kishin kapur disa vargje-ajete të cilat e qortonin Muhammedin s.a.v.s., ose disa ajete të cilat parë nga këndvështrimi i tyre dukeshin kontradiktore dhe të pa harmonizuara. Ata i publikuan këto dyshime, duke trumbetuar se Kur'ani nuk është i libër i "shenjtë" por është libër si të gjitha librat e tjerë njerë-

zorë. Të gjitha ato dyshime u eliminuan nga dijetarët dhe studiuesit muslimanë. Ndërsa ne, deri më sot, ende nuk kemi informacion se dikush prej këtyre orientalistëve ose të tjerë iu janë kundërpërgjigjur dijetarëve muslimanë.

Muhammedi s.a.v.s. nuk ishte vetëm në shënjestër të orientalistëve por, ai gjithashtu përcillej dhe përcillet vazhdimisht edhe sot nga historianë jo muslimanë. Këta e shohin atë si një prijës shumë të zotë, por vizioni tij nuk ishte më shumë se sa të bashkonte fiset arabe. Qëllimi i jomuslimanëve është që të sjellin sa më shumë argumente të cilat vërtetojnë se Muhammedi s.a.v.s. nuk ishte i Dërguar i Zotit por, ishte si të gjithë të tjerët. Ndërsa Krijuesi ia kishte bërë të qartë, si Muhammedit s.a.v.s. ashtu edhe mbarë njerëzimit se ai ishte i Dërguari i fundit dhe se mesazhi tij ishte mbarënjëzëzor.

Një prej këtyre është historiani Muir, i cili në librin e tij "The Caliphate", pp. 43-44 thotë: "Ideja për ta bërë Shpalljen të përgjithshme ka ardhur më vonë, edhe pse kemi shumë ajete kur'anore që flasin për këtë çështje, vetë Muhammedi s.a.v.s. nuk e kishte idenë, gjithçka ai mendonte ishin fiset arabe, ashtu siç janë edhe mesazhet e kësaj feje të re. Që kur ka filluar me thirrjen e tij, ai nuk i është drejtuar tjetër kujt përveç arabëve. Duket qartë se idetë globaliste lindën nga rrethanat e krijuara në atë kohë, gjithmonë duke pasur programe dhe strategji të mirëfillta" Si ky mendojnë shumë hulumtues të tjerë të shkencave shoqërore, sikurse Bernard Luis, Karen Amsrtong...

Mesazhet

Shikuar në aspektin thjesht historik, vërtet, fiziku i Muhammedit s.a.v.s. nuk arriti ta çlirojë Afrikën, Persinë ose Bizantin e më gjerë, por ajo që argumenton se ai ishte i dërguar për mbarë njerëzimin janë shumë ajete kur'anore

dhe disa prej thënieve të vetë Muhammedit s.a.v.s.. Sa për ilustrim do të sjell vetëm një ajet të Kur'anit: "Ne të kemi dërguar ty (o Muhammed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk e dinë".

S'do mend se historianët nuk merren me hollësitë rreth rrethanave të betejave ose parapërgatitjeve të tyre, sepse këto fusha i mbulojnë studiues të shkencave të tjera, prandaj kundërshtarët e Muhammedit s.a.v.s. duke qenë se nuk i njihnin ose nuk i njohin mirë zhvillimet historike, sociologjike, psikologjike etj, e kundërshtojnë veprën e tij. Duke qenë se më duhet t'i përgjigjem z. Muir, kur thotë se 'Muhammedi nuk e kishte idenë, gjithçka ai mendonte ishin fiset arabe...' themi se e ka gabim. Nga shumë ngjarje të jetës së Muhammedit s.a.v.s., të cilat argumentojnë se ai e dinte mirë misionin e tij si i Dërguar i njerëzimit, ne do të sjellim vetëm një ngjarje të tij. Përshkruarit e parë të haditheve-jetës së Muhammedit s.a.v.s., kanë treguar se si është bërë parapërgatitja e muslimanëve në mbrojtje të qytetit të Medinës, në luftën e Ahzabit në vitin e pestë të hixhretit. Gjatë hapjes së kanalit-hendekut disa gërmues kishin hasur në një shkëmb të madh. Derisa po mendonin se si t'ia bënin, përreth tyre kaloi Muhammedi s.a.v.s. Pas një konsulte Muhammedi s.a.v.s. mori kazmën dhe e goditi shkëmbin tri herë dhe ai u shkërmoq. Të pranishmit (Selman Faresiu dhe tre të tjerë) i thanë: o i Dërguari All-llahut, derisa i mëshoje shkëmbit, shihnim shkëlqim në shkëmb. Ai iu tha: kur e godita herën e parë, pashë çlirimin e Persisë dhe ç'ka përreth saj, ndërsa kur godita për herë të dytë pashë çlirimin e Bizantit dhe ç'ka përreth tij, dhe në goditjen e tretë pashë çlirimin e Egjiptit dhe ç'ka përreth tij.

Se vizioni i Muhammedit s.a.v.s. ishte mbarënjëzëzor flasin edhe shumë fakte të tjera, si ai i rregullimit të shtetit të tij. Ai kishte formuar sistem të përsosur në

marrëdhëniet e tij me qytetarët. Ai nuk i dallonte qytetarët e tij, çdo gjë ishte me ligj dhe të gjithë ishin të mbrojtur nga shteti. Nëse i hedhim një vështrim politik, ai kishte iniciuar Kartën e Medinës, e cila sot njihet si Kushtetuta e parë njerëzore. Pikat e renditura në këtë marrëveshje, tregonin se si duhet të bashkëjetojnë ose bashkëveprojnë midis vete qytetarët e shtetit islam edhe pse mund të kanë ide të kundërta, dhe si do të duhej të ishin kompakt në mbrojtjen e vendit të tyre kundër armiqve shkatërrues.

Mesazhet e shumta të tij dhe këshillat e panumërta kur'anore ende nuk po merren parasysh edhe sot nga njerëzimi mbarë, edhe pse sot ka zëra që thonë se njerëzimi duhet t'i zgjidhë problemet me mjete paqësore. Marrëveshjet e nënshkruara midis shteteve gjatë shekullit të kaluar, sikur kishin dhënë shpresë për zgjidhjen e problemeve në mënyrë paqësore, por ky shekull (XXI) sikur ka filluar të na kthejë mbrapa. Kjo na lë të kuptojmë se njeriu pa ndihmën hyjnore nuk do të jetë asnjëherë në gjendje ta bashkojë dhe ta vë në jetë sistemin mbarënjëzësor.

Elitat nga bota joislame duhet ta studiojnë me saktësi Islamin dhe të japin konkluzionet e tyre, e pastaj të vendosin se cili është sistemi më i mirë për qenien njerëzore. Bernard Lewis këshillon elitën e shteteve perëndimore të kenë kujdes me Islamin dhe të mos nxitojnë në deklaratat e tyre. Ai thotë: "Islami nuk është një vend; ai është fe. Por për muslimanët fjala "fe" nuk ka të njëjtin konotacion që ka për të krishterët ose që kishte për të krishterët e Mesjetës. Për muslimanët, "fe" do të thotë diçka më shumë dhe diçka më pak në krahasim me atë që termi ekuivalent do të thotë për të krishterët..."

Bonaparti për Muhammedin s.a.v.s.

Njerëzimi duhet ta pranojë Muhammedin s.a.v.s. si njeriun e vetëm, i cili ishte bartës i mesazhit hyjnor për të drejtuar njerëzimin. Këtë e kishte vërejtur edhe perandori francez Napoleon Bonaparti i cili në një letër të shkruar prej tij, më 28 gusht 1799, thotë: "Unë shpresoj se s'do të kalojë shumë kohë, kur të urtët e botës do të bashkohen dhe do t'i zgjidhin problemet e botës, sipas parimeve të Kur'anit. Vetëm ato janë të drejta dhe i garantojnë njerëzimit lumturinë". Ai për Muhammedin s.a.v.s. gjithashtu ka thënë:

"Mojsiu, fenë e Zotit ia shpalli popullit të vet, Jezusi botës romake, kurse Muhammedi tërë botës. Arabia ishte vend pagan. Gjashtë shekuj pas Jezusit, Muhammedi e njohu botën me besimin në Një Zot të vetëm, që është Zoti i Ibrahimit, i Mojsiut dhe Jezusit. Arianët dhe sektarët e tjerë, e çoroditën botën me diskutime mbi trinitetin: Atin, birin dhe shpirtin e shenjtë. Ndërkaq Muhammedi, shpalli se Zoti është Një, kurse triniteti imponon idenë e idhujtarisë".

Duke i nisur nga këto thënie të sipërtheksuara, fshehja e argumenteve nuk e ndihmon askënd. Nëse dikush mendon të kundërtën themi se ajo është e përkohshme dhe i përket vetëm kësaj bote. Të gjithë ata persona që marrin mbi vete përgjegjësinë për të drejtuar një vend, popull ose njerëzimin mbarë, duhet ta kenë parasysh se një ditë do të përgjigjen për veprimet e tyre. Ata gjithashtu, duhet ta kuptojnë se nëse njerëzimi largohet nga këshillat hyjnore, do të vuajë dhe do të humbë kohë, sikurse kemi tani rastin e freskët me problemin e mbrojtjes globale.

Cila është rruga?

Muhammedi s.a.v.s. është shembull për ne. Ai nuk la trashëgimtar e as nuk e zgjodhi ndokënd ta drejtonte shtetin e ri. Në fakt, ai kishte dhënë shenjat dhe pëlqimin e tij, por asnjëherë nuk e shpalli për zëvendës askënd prej bashkëveprimtarëve të tij. Ai ishte i pazëvendësueshëm, prandaj këtë vendim ia la që ta zgjidhte vetë populli. Kështu, për herë të parë në historinë e njerëzimit mësojmë se udhëheqësi duhet të zgjidhet nga populli dhe pa imponime.

Nga historia e Muhammedit s.a.v.s. përveç mësimëve të fesë, morëm edhe formën qeverisjes së shtetit. Mësuam si të sillemi në diplomaci, politikë dhe administratë, ndërsa formën e udhëheqjes në praktikë, e mësuam nga katër kalifët e parë. Shteti Islam është shtet që udhëhiqet nga Kalifi. Sot këtij sistemi mund t'i thuhet se është shtet presidencial. Kalifi propozohet, ndërsa betimin-votën e merr nga populli.

Në kohën kur njerëzimi udhëhiqej nga mbretër e perandorë, me një fjalë nga diktatorë, njerëzimi për herë të parë mësoi për një formë të re të zgjedhjeve. Këtë formë të udhëheqjes

njerëzimi filloi ta praktikojë vetëm nga mësimet e Islamit. Pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s., u zgjodh Ebu Bekri, i propozuar nga një grup shokësh dhe i votuar nga qytetarët. Fillimisht u votua nga qytetarët e Medinës e pastaj nga qytetarët e qyteteve të tjera. Ndërsa Omeri u zgjodh në të njëjtën rrugë, por i propozuar si kandidat i vetëm nga Ebu Bekri i cili ishte para vdekjes. Uthmani u zgjodh si rezultat i garës midis gjashtë kandidatëve, ndërsa Aliu u votua si kandidat i vetëm sepse në garat me Uthmanin ishte radhitur i dyti nga gjashtë kandidatët e tjerë.

Me vdekjen e Aliut mori fund kalifati i mirëfilltë, për t'u zëvendësuar me perandorin-kalif, zgjedhja e të cilit do të trashëgohej nga njëri prej bijve të tij. Veprimtaria e perandorit-kalif, fillimisht ishte shumë afër veprimeve të kalifit të mirëfilltë, por me kalimin e shekujve, në kohën e Sulltanëve-kalif, ky emër u bastardua, saqë u lejua vëllavrasja brenda oborrit sulltanor: "Ai prej djemve të mi, të cilit do t'i takojë fronin i Sulltanit, ka tagër, në emër të rendit të botës, të vrasë të vëllezërit. Këtë e kanë miratuar edhe të gjithë dijetarët e ligjit. Kështu pra, të bëhet".

Bota sot, i ka të gjitha atributet për të qenë një, edhe pse tani për tani i mungojnë disa elementë. Për të qenë në rrugë të mbarë asaj i duhet t'i kultivojë idetë për të bërë njohjen reciproke. "Për shembull, njohje e ndërsjellë do të thotë kur qytetarët fetarë dhe sekularë janë në gjendje që në debatet publike ta dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të mësojnë nga njëri tjetri". Kjo formë e qeverisjes ishte jetësuar në kohën e Muhammedit s.a.v.s. dhe Katër Kalifëve të Drejtë, por, me shkuarjen e tyre bota sërish ra nën presionin e pushtetarëve lakmitarë. Sot bota vuan për një Kalif të mirëfilltë i cili do të defilonte paqen në mbarë rruzullin botëror. ■



Debat mbi Islamofobi

DAGENS NYHETER

Islamofobi

DEBATT: ISLAMOFABI



Palestinska muslimer som väntar på att släppas förbi en israelisk vägspärr för att kunna be i Al Aqsa-moskén i Jerusalem. Foto: Kevin Frayer/AP

Bli moderna nu, annars...

Liksom en gång judarna har nu "muslimer" buntats ihop till en enhet och blivit en projektionsyta för allt det som vår kultur vill förneka hos sig själv, skriver Eva Ekselius.

VÅR RÄTTMÄTIGA upprördhet över sinsemellan så olika företeelser som politiska terrorhandlingar och

Tidigare inlägg: ANDREAS MALMS ARTIKLAR

Debatuесе: Eva Ekselius

Shketësimi dhe pakënaqësia jonë e arsyeshme për fenomenet e ndryshme, sikurse aksionet terroriste e po ashtu edhe vrasjet apo krimet për shkak të nderit (në Suedi dhe në disa vende të BE-së ka pasur disa raste të tilla), kanë ofruar një legjitimitet që i tradhton dhe i bën jobindëse edhe anët e errëta të islamofobisë: armiqësinë ndaj të huajve dhe racizmin. Kjo në fakt ka ngjashmëri të madhe me antisemitizmin që pat mbërritur kulminacionin nën nazizëm.

Por debati sjell konfuzion kur dikush e trajton fjalën Islam si fenomen, që në fakt është bërë një fjalë ombrellë apo mbulesë për gjëra krejt të tjera. Gjuha ka mbetur prapa. Na duhen fjalë të reja

që të na e bëjnë të qartë se çka është ajo për të cilën po diskutojmë.

Në debatin ndërkombëtar, njerëzit flasin për Islamit politik për të bërë një dallim të qartë në mes të religjionit të Islamit dhe lëvizjeve dhe ideologjive politike që flasin në emër të Islamit. Në suedisht u përdor fjalë islamizëm në përpjekje për të bërë një dallim mes të dyjave. Por kjo fjalë është një fjalë e rrezikshme dhe dezorientuese pasi jep përshtypjen e gabuar se bëhet fjalë për një drejtim apo lëvizje ekstreme brenda religjionit Islam.

Islami politik është në anën tjetër një ideologji politike që lufton për krijimin e shteteve teokratike (religjioze) dhe model mund të jetë p.sh. Irani i sotëm. Por termi mund të përfshijë edhe lëvizjet postkoloniale globale që kërkojnë një

korrigjim apo edhe shpëtim kolektiv pas shfrytëzimit qindravjeçar ekonomik dhe politik nga hegjemonia kulturore perëndimore. Kështu mund të flitet për ekstremizëm politik që propagandon terrorin si mjet, e deri te pakënaqësitë dhe protesta popullore jo të artikuluara mirë kundër represionit të përtjetuar.

Shembulli i Ballkanit dhe Palestinës

Ne e kemi parë këtë në Ballkan para dhe gjatë luftës. Përveç luftës politike dhe ushtarake, serbët dhe kroatët propaganduan një retorikë historike mbi muslimanët si një element i huaj. Si përgjigje ndaj kësaj retorike (që shpejt u shndërrua në përndjekje dhe krime lufte) gratë dhe vajzat e reja që ishin shekullarizuar me gjenerata të tëra vendosën të përdorin shamitë, ndërsa djemtë e rinj filluan të mobilizohen si aktivistë muslimanë. Në Bregun Perëndimor (Palestinë) që ishte pranë krijimit të një shteti modern shekullar, por që u mashtrua nga premtimet e marrëveshjes së Oslos, e pamë se si frustrimi erdhi në të njëjtën formë: çdo vit më shumë femra me fustane, shamia dhe rroba të gjata dhe gjithnjë e më pak në jeans-a dhe në bluza të shkurtra. Kjo ishte një protestë politike, por e shprehur me rroba religjioze. Religjioni u shndërrua në simbol të identitetit nacional (edhe pse fjala komb është bërë më pak relevante në këtë kontekst) dhe bartja e kësaj embleme paraqitet si veprim rezistence. Fitorja e Hamasit në Gaza mund të shihet si një shenjë për dorëzimin politik: ata që besojnë ende në një shtet modern demokratik dhe shekullar janë gjithnjë e më pak në numër.

Rasti apo përzjerja e dytë ndodh kur Islami bëhet sinonim me zakonet tradicionale, shpesh edhe më të vjetra sesa vet religjioni dhe të përhapura në shumë kontinente në botë. Kulturat për dhe mbi nderin kanë mbijetuar në rajone ku institucionet demokratike nuk kanë arritur të zhvillohen, qoftë për shkak se njerëzit kanë jetuar nën regjime totalitare ose qoftë për shkak se nuk kanë pasur shtete të veta. Shumë nga këto tradita që neve nuk na pëlqejnë kanë mbijetuar në fise dhe klane nëpër vendbanime krye-

Bobinë në Perëndim

sisht rurale dhe duhet të shqyrtohen dhe gjykohen nga perspektiva zhvillimore. Dallimi është më shumë në kohë sesa në religjion. Evropës i janë dashur disa qindra vite për të kaluar nga traditat në modernitet, për të kaluar nga një shoqëri feudale në një shoqëri demokratike. Janë bërë disa luftëra, dy luftëra botërore, dhe çmimi më i lartë u pagua nga rreth 11 milionë banorë që u shuan gjatë gjenocidit të madh evropian, para më pak se 70 vitesh. Dhe tani pas gjithë këtyre gjërave ne po presim që popujt e tjerë do ta zënë hapin dhe zhvillimin gjatë një gjenerate dhe pa fërkime apo tensione sociale.

Racizmi...

Rasti apo shembulli i tretë që fshihet pas islamofobisë është racizmi i pastër. Matti Bunzl thotë (sipas Anders Malm) se racizmi dallon nga antisemitizmi duke qenë global dhe jo i lidhur me kombin. Por ky fenomen tregon përshtatshmëri ndaj

ndryshimeve historike dhe realiteteve të ndryshme aktuale. Ngjashmëritë me antisemitizmin mbesin dhe prej tyre ne duhet të mësojmë ose tërheqim vërejtjen. Ashtu sikurse hebrenjtë që u paraqitën apo u prezantuan si të huaj të ndryshëm, nëpërmes të cilëve ata mund të paraqiteshin dhe epitete që kultura jonë nuk i pranonte se janë edhe brenda saj, tani këto epitete të vjetra mbi antisemitizmin po i vishen muslimanëve. Për të parë më mirë ngjashmëritë dhe të pakëndshmen dhe të poshtëruarën në islamofobi ne duhet vetëm të ndërrojmë karikaturat daneze dhe simbolet fyese (që i ishin bërë fesë islame nga autorë të ndryshëm danezë dhe skandinavë, vërejtje: B.B.) me një variant hebre, pra të ndryshojmë fokusin dhe të paraqesim hebrenjtë si të tillë dhe t'i fyejmë ata. A do të mendonim edhe më tej se janë humoristike dhe pjesë satirike të qëlluara?

Përvoja e hebrenjve tregon se veçoritë kulturore tek gjenerata e parë

nuk paraqesin ndonjë rrezik për kulturën lokale nacionale. Janë gjeneratat e tjera ato të cilët janë të kërcënuara nga zhdukja dhe të cilave iu duhet përkrahja publike për të mbijetuar. Procesi i asimilimit është një forcë shumë dinamike vepruese kështu që ne duhet të kemi një politikë kulturore të vetëdijshme dhe të mirë për të ruajtur shumësinë e kulturave apo multietnicitetin.

Sot janë xhamitë që po kallen, shtëpitë dhe dyqanet e muslimanëve të cilave po iu thyhen xhamat. Ne e kemi parë këtë më herët dhe e dimë se ku mund të çojë kjo. Ne bartim të njëjtën përgjegjësi sikurse atëherë, ashtu që asnjë njeri i pafajshëm të mos bartë përgjegjësi për atë që e kanë bërë dhe e bëjnë të tjerët, apo për atë që kemi frikë se edhe vet do ta bënim. ■

Marrë nga gazeta suedeze
"Dagens Nyheter"

Nga suedishtja: Burim Breznica



Mustafë Kokaj së bashku me Hasan Remnikun, ishin simboli i rezistencës kundër pushtimit jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore. Së bashku me patriotë të tjerë, përfshirë Hasan Remnikun, u vra pabesisht në një pusi që ia kishte përgatitur OZNA më 11 tetor të vitit 1951. Pas vrasjes, trupi i tij u ekspozua në Gjilan, si formë dhe mënyrë represive për të frikësuar banorët e kësaj ane të Kosovës.



Nijazi RAMADANI

Në fillim të qershorit të vitit 1951, dy oficerë të lartë të UDB-së e ndiqnin hap pas hapi mësuesin atdhetar Mustafë Kokaj, i cili në periudhën 1944-1947 ishte shkolluar në Tiranë për mësues. Mustafa, me t'u kthyer në Kosovë, filloi punën si mësues, një nevojë shumë e madhe kjo për malësorët e Karadakut dhe banorët e Anamoravës.

Ardhjen e UDB-së në shkollën e fshatit Remnik, ku ishte emëruar mësues i shkollës fillore, mësuesi e parandiente si kob i rikthyer nga ajo ditë që kishte përcjellë për në burg, babanë Hetë, axhën Muharremin dhe bijtë e vëllait, kur ishte kthyer pasi që i ishte bashkuar Brigadës shqiptare të komanduar nga Komandant Haxhiu i rrethit të Mbishkodrës. Prapë, nga gjysma e qershorit të vitit 1951, ata i trokasën në derën e banesës së tij në Remnik. Pak para se mësuesi të kthehej nga një mbledhje e fshatit, ku kërkohet që ta dorëzonin njeriun e fundit të ilegales, Hasan Alinë, Lila dhe Voja, futën të paftuar në banesën e tij, kinse për ta kaluar natën, por qëllimi i tyre, ishte që ta dëbojnë atë përtej bjeshkëve. Voja i tha: -Ik, ose ulu në këmbët tona! Mësuesi iu kërkoi me ngulm që ta lëshonin banesën e tij, por ata as që lëvizën, duke kërkuar që t'ia sjellin edhe gruan që t'u shërbente atyre. Këtë nuk mund ta përpinte dhe shkoi për të fjetur te shërbëtori i shkollës. Atje ai e kishte një revole të tipit Beretë për të ruajtur kokën. Ndonëse të dy udbashët

Mustafë Kokaj, mësuesi që

iu sulën, duke e përgjakur fytyrën e tij nëntëmbëdhjetëvjeçare, Mustafa nuk u dha fare para tyre. U ngrit me forcën e fundit në këmbë, dhe mezi shkoi te portieri i shkollës që të bënte një sy gjumë, por, mjerisht atë natë nuk fjeti fare. Para se të shkonte kinse të flejë, ai pa në oborrin e shtëpisë fëmijët e axhës së tij që kishin dalë për ta pritur. Por atë ditë nuk patën kohë për t'u përshëndetur sepse u kthyen për të përcjellë ardhjen e UDB-së. Mësuesi ishte përshëndetur me një mik, i cili vdiq gjashtë javë më vonë nga torturat e UDB-së dhe që nuk i tradhtoi shokët dhe Mustafën deri në vdekje. Ai kishte në burg babën, axhën dhe i vëllain e madh. I morën në besë për t'i amnistuar më vonë, por a ka besë dhelpër? I dënuan përjetë. Vetëm vëllai i madh kishte shpresë të dalë nga burgu. Iu kujtua babai, xhaxhai dhe vëllezërit në burgun e Nishit. Xhaxhai tjetër, i vvarë në frontin lindor, e shumë e shumë tragjedi tjera. Andaj vendosi t'i kthehet malit, nuk pati tjetër udhë...

Vrasja e dy udbashëve...

Mori revolen Beret, që e kishte amanet nga babai, dhe iu kthye "mysafirëve" në odën e tij për ta dërguar amanetin e etërve në vend. Me të hyrë në derë, i gjeti duke luajtur shah, por në vend se t'i luante figurat e shahut për t'i zënë mat, ai nxori revolen dhe e zbrazi mbi ta. Duke dalë jashtë me nxitim, pa gruan e axhës Metë në oborrin e shtëpisë së tij. Fjalët mezi i dolën nga goja dhe i tha: -Thuaj, se i vrau mësuesi Mustafë, se e zuri gjaku që po i vlonte pas gjithë asaj që na bënë. Nuk pata qare, nuk e bëra për nam as nishan.

Me të dalë nga katundi, ecte serbes nga ana e malit, nxitonte duke hedhur hapin nga Mulliri i Hanit të Haxhtë. Aty la një fasule që ia kishte dhënë nusja e tij, Raba, për të mos e zënë gjaku. Theu rrugën dhe kaloi nga shkolla e Ukë Metave, për të zbritur pastaj në lumin Llapushnicë dhe për të vazhduar rrugës që e nxirrte te Muhaxhirët e Kokajve. Kaloi shtëpi më shtëpi, mal më mal e gur më gur, deri në jatakun më të sigurt. Më vonë ra në lidhje me Hasan Alinë dhe bashkë me të vendosën të largohen, për shkak se ishte shtuar zullumi mbi jatakët e tyre. Nga fillimi i vjeshtës shkuan në anën tjetër të Arbërisë së lirë. Ata nuk arritën ta kapërcenin malin për të dalë përtej gardhit. Bënte mjegull dhe binte vazhdimisht shi. Ishte një mot i lig që mbahej mend më gjatë se herëve të tjera. Atij iu kujtuan të gjitha tragjeditë që kishte shkaktuar pushtuesi mbi popullin e tij për ta zhdukur dhe përzënë. Mustafa në këtë moment të vështirë ndiente një krenari dhe kishte shpresë se popullin e tij nuk do të mund ta zhdukte as tash ky pushtues, ashtu siç nuk kishte mundur ta zhdukte asnjë pushtues deri më tash. Ai kujtonte disa popuj të tjerë që kishin jetuar në antikitet si: thrakët, avarët etj. e sot nuk ishin më. Edhe dyndjet me origjinë mongole që ishin munduar të na mbanin nën sundimin e tyre, të asimilonin e të zhduknin çdo gjë që gjenin mbi tokë dhe nën tokën e pasur. Por papërkulshmëria dhe lufta e vazhdueshme, edhe pse na kishin zvogëluar në masë, kishin bërë që të mos arrinin të na zhduknin asnjëherë. Një ditë vjeshte, deri sa po priste lidhjen në Koka, kishte vendosur të rrezikonte: do të qëndronte në kullën e vet. Mustafa po e mbante



Pamja e sotshme e lagjes në Kokaj ku ka lindur mësuesi Mustafë Koka

ë nuk pajtohej me robërinë

besën që i kishte dhënë nënës se nuk do të binte në duar UDB-së për ta pësuar si ishte keq e më keq, ashtu siç i kishte ndodhur babait të tij, edhe pas amnistisë së premtuar. Mustafa e nuhati i pari tradhtinë dhe nuk e lëshonte nga tyta e armës Malin e Zenunit. Iu kujtua edhe vrasja gjatë luftës, disa vjet më parë, buzë kufijve të gardhit të thurur me zapti edhe aty ku kurrë nuk e patën vendin. Edhe një i afërm i tij, Feza e kishte pas lënë me fjalë të varrosët në mezhde të kufirit për të cilin kishte luftuar gjithmonë para se ta lëshonin në mënyrë kolektive tokën te Molla e Kuqe, për t'i shpëtuar shfarosjes. Sipas planit të marrë nga UDB-ja e dinte se Hasan Alia do të goditej në gjoks, Mustafa në kokë, ndërsa Agush Bresalci do të pritej me breshëri, ndërkohë që do të kalonte lumin me gruan e tij në shpinë. Mustafa e mbante përkrahu gruan, Rabën. Ai mbante edhe armë të gjatë, edhe një revole Beretë që e kishte amanet nga vëllai i tij, Ajeti. Beretën e mbante në brez. Pas kësaj, duke kaluar me hapa të shpejtuar nëpër një rrafshinë, për herë të parë, pas gjithë asaj lufte, po e tradhtonte mendja. Në këtë heshtje shkrepën dy armë, sixhim. Menjëherë pas kësaj u ndezën kandilat e turpit për ta ndritur terrenin, deri sa Mustafa me Agushin i prenë dritat me rafalët e tyre, me qëllim që ta mbulonin terrenin me terrin e asaj nate të pabesë, që ishte improvizuar si në skenë të teatrit, te vendtakimi në lumin Bistricë. Dritat e kthyera në drejtim të tyre, së bashku me sirenën e trupave pushtuese fare pranë tyre, po e ndriçonin ujin e Drinit të përgjakur prej tre burrave dhe dy grave. Ndërsa një ushtar i ri, po i përgjigjej zërit të gruas së Agushit, Qibrije, për t'i dhënë një pikë ujë me grusht. Këtë e ndaloi Komandanti Kristë, duke ia sharë nënën shqiptare... Do t'iu vrasim të gjithëve. Lama e miellit të kazasë po i priste në agun e parë. As në emër të katundit nuk ua dhanë kufomat, as të mësuesit të vrarë bashkë me bashkëshorten e tij, dhe as të tre kaçakëve të tjerë. Familja e ngushtë e mësuesit kishte mbetur me gra e fëmijë. Nëna mallkonte edhe në ditën e tretë që ata ishin ekspozuar te pazari i Lamës... Asnjë gjëmë, asnjë pikë lot nuk i kishte dalë asaj burrëreshe, as para masës së dalë te Lama e miellit.

Kush ishte mësuesi Mustafë Rushiti-Kokaj?

Mustafë Koka, i njohur edhe si Mustafë mësuesi, u lind në Kokaj më 1931. Ai ishte i biri i Hetë Kokajt, kaçak i njohur nga viti 1924 deri me 1944, ndërsa më 1947 ai u kap nga UDB-ja dhe u dënua me 35 vjet burg së bashku me vëllain e tij. Babai i tij, Hetem Rushiti-Hetë Koka në gusht të vitit 1947 u burgos në Gjilan dhe u dënua me vdekje. Dënimi iu shndërrua në 20 vjet



Portreti i mësuesit Mustafë Rushiti - Kokaj

burg. 12 vjet i kaloi në Nish. Vdiq në burg në moshën 73 vjeçare nga torturat. Varri nuk i dihet. Xhaxhai i Mustafës, Muharrem Rushiti në gusht të vitit 1947 u burgos në Gjilan dhe u dënua me 13 vjet burg, por qëndroi 7 vjet. Muharremi, pors i vëllai Hetemi, vdiq në burgun e Nishit nga torturat e mëdha. Edhe vëllai i Mustafës, Ajet Rushiti, në tetor të vitit 1946 u dënua me 13 vjet burg në Mitrovicën e Sremit dhe qëndroi 10 vjet burg. Jetoj nga viti 1975 në fshatin Leran të Preshevës. Vehbi Hetë - Kokaj më tetor të vitit 1946 u dënua 6 vjet burg në Prishtinë. Një vit e gjysmë i kaloi në Prishtinë, kurse 1 vit në Mitrovicë. Ishte 17 vjeç. Pas Aksionit të Armëve u shpërngul në Kumanovë. (Sipas kujtesës së Vehbi Etem Rushitit, i lindur më 2 shtator 1929 në fshatin Kokaj, që jetoj në Kumanovë që nga viti 1971 dhe që rrëfeu për ekzekutimet dhe torturat e rënda fizike ndaj familjes Rushiti).

Mustafë Koka gjatë tri viteve të fundit 1944-47, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore qëndroi në Tiranë, ku kreu kualifikimin për mësues. Me t'u kthyer në Kosovë, filloi punën si mësime të mësimdhënës, një nevojë shumë e madhe kjo për malësorët e Karadakut dhe banorët e Anamoravës. Puna e Mustafë Kokës në fushën e arsimit nuk zgjati shumë. Pushteti komunist jugosllav për shqiptarët e Kosovës u bë i padurueshëm, kështu që Mustafa vendosi të ballafaqohej me pushtuesin edhe në mënyrë të armatosur. Për disa vite resht, Mustafë Kokaj së bashku me Hasan Remnikun, ishin simboli i rezistencës kundër pushtimit jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore. Së bashku me patriotë të tjerë, përfshirë Hasan Remnikun, u vra pabesisht në një pusi që ia kishte përgatitur OZNA më 11 tetor të vitit 1951. Pas vrasjes, trupi i tij u ekspozua në Gjilan, si formë dhe mënyrë represive për të frikësuar banorët e kësaj ane të Kosovës.

Duke u bazuar në këtë aktivitet të Mustafë Kokës, regjisor i njohur jugosllav, Veljko Bulajiq, sipas skenarit "Poslednje Albanske Bande na Kosometu" (Bandat e Fundit të Shqiptarëve në Kosovë), xhironi filmin e njohur Kapetan Lleshi. Mësuesi që paraqitet në këtë film është Mustafa, kurse vendi është fshati Kokaj. Natyrisht, filmi paraqet ngjarjen e rregulluar sipas shijes së pushtetit komunist serb. Mustafë Hetem Rushiti pas një përleshje me dy udbashë gjatë përpjekjes për arrestimin e tij në Remnik, i vrau të (dy udbashët) dhe doli në mal me Hasan Alinë e Remnikut. Ata u vranë tradhtisht në vendkalimin kufitar në Bistricë të Prizrenit. Mustafa ishte 21 vjeçar dhe ishte shkolluar në Gjimnazin e Tiranës. Në fund të vitit 1947 u kthye nga Tirana për të përmbushur nevojat e arsimit shqip në Kosovë. Varri nuk i dihet. Rabije Kokaj, (gruaja e Mustafës), në shtator 1951 në Zhur të Prizrenit u masakrua nga UDB-ja bashkë me të shoqin, Mustafë Etemin. Ishte 20 vjeçare. Varri nuk i dihet. Hasan Alia-Remniku më shtator 1951 në një vendkalim të Prizrenit u kap apo iu inskenua vrasja nga UDB-ja bashkë me Mustafën dhe Rabijën. Ishte 48 vjeçar. Varri nuk i dihet. Të vrarë në atë aksion kanë mbetur edhe Agush Metaj Bresalci, 35 vjeçar, dhe Qibrije Agush Bresalci. ■

Narkomania po merr përmasa shqetësuese në Kosovë

Edhe fëmijët konsumues të pluhurit të bardhë

Sipas një raporti të publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) konsumimi i drogës nga nxënësit e shkollave në Kosovë është në nivelin e krahasueshëm me shtetet e BE-së. Sipas këtij raporti, në Kosovë përdoren të gjitha llojet e drogës, ndërkohë që ka rritje të dukshme të përdorimit të heroinës



Fatos SHALA

Narkomania në Kosovë kohët e fundit ka marrë përmasa shqetësuese. Numri i narkomanëve po rritet me shpejtësi të madhe, ndërkohë që asnjë institucion nuk ka të dhëna për numrin e narkomanëve e as për sasinë e drogës që konsumohet në Kosovë.

Numri i narkomanëve po rritet në mënyrë të frikshme. Të rinjtë mbeten edhe më tutje konsumuesit dhe viktimat potenciale. Narkomani dhe narkomania hap edhe probleme e plagë të tjera sociale si vjedhja, prostitucioni, dramet familjare, depresionin dhe streset, të cilat edhe ashtu janë mjaft të pranishme në shoqërinë tonë të pasluftës.

Shumica e të varurve nga pluhuri i bardhë dhe llojet e tjera të drogës nuk paraqiten nëpër klinika. Në fakt është një numër i vogël i konsumuesve të drogës që paraqiten për shërim, dhe kjo në rastet kur varësia bëhet ekstreme, por ky numër nuk përputhet as për së afërmi me numrin e personave që realisht konsumojnë drogë.

Konsumuesit e drogës mosparaqitjen nëpër klinika e arsyejnë me faktin se kjo kategori e njerëzve shikohet si "dele e zezë" në shoqëri.

Pakkush merret me narkomanët dhe narkomaninë në Kosovë

Pos disa shkrimeve të rastit nëpër media me rastin e ditës së luftës kundër drogës, apo ligjëratave të kohëpas-kohshme nëpër shkolla të mesme nga arsimtarët, a ndonjë specialist, pakkush merret me narkomanët dhe narkoman-

inë në Kosovë. Institucione të specializuara për narkomanët nuk ka. Shumica e institucioneve vlerësojnë se popullata e pasluftës ka probleme më të mprehta se sa droga.

Po cilat janë mundësitë e institucioneve shëndetësore në Kosovë apo institucioneve të specializuara që t'u ndihmojnë narkomanëve? Dr. Ilir Tolaj, thotë: "Në Kosovë nuk kemi qendër rehabilituese për narkomanët dhe as mundësi materiale për një tretman më të gjatë. Na mungojnë edhe specialistët".

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), në një raport të majit 2001 për Kosovë, shkruan: "1. Në Kosovë për-



doren të gjitha llojet e drogës. 2. Droga konsumohet nga nxënësit e shkollave në një nivel që është i krahasueshëm me shtetet e BE-së. 3. Ka rritje të dukshme të përdorimit të heroinës. 4. Përdorimi i shiringave për marrjen e drogës është më i vogël se sa në BE. 5. Është sinjifikative lehtësia e marrjes së narkotikëve nëpër barnatore. 6. Është më i madh përdorimi i shiringave nga dy a më shumë veta".

Më së shumti narkomanë në Prishtinë dhe në Gjiilan

Droga në Kosovë mund të gjendet me lehtësi dhe me çmim shumë të lirë. Rastet e paraqitura në Klinikën Neuropsikiatrike të Prishtinës dëshmojnë se droga më së shumti konsumohet në

Prishtinë dhe në Gjiilan. Ka dyshime se trafikantët ua shpërndajnë falas drogën nxënësve të shkollave fillore, duke "rekrutuar" konsumatorë të ardhshëm. Këtë e pohojnë edhe Toni dhe Agimi ish nxënës të shkollës fillore "Gjergj Fishta" në Prishtinë, të cilët thonë se e kanë provuar një herë, falas, por kurrë nuk e kanë vazhduar më.

Edhe psikologu Fitim Uka shprehet i shqetësuar për numrin e madh të përdoruesve të drogës. Ai, po ashtu, pohon se shumica e këtyre konsumuesve të drogës janë fëmijë. "Mund të thuhet se përdoruesit e shumtë të drogës në Kosovë janë në një farë mënyrë pasojë, por edhe përgjegjësi e shoqërisë, por në radhë të parë e familjes. Familja duhet të jetë institucioni që mban kontakt me adoleshentin dhe të riun, që i jep mundësinë të shprehet dhe të tregojë për problemet dhe që i ndihmon atij të gjejë zgjidhje. Në të kundërtën, mbyllja në vetvete dërgon drejt depresionit që mund të rezultojë me përdorimin e substancave narkotike apo edhe me aktin e vetëvrasjes" - shprehet psikologu Uka.

Heroina më e preferuara

Pas luftës, në Klinikën Neuropsikiatrike të Prishtinës janë trajtuar shumë raste (katër kanë vdekur në spital, ndërsa tre nga ish-pacientet kanë vdekur në shtëpi), 90 për qind e të cilëve e kanë konsumuar heroinën, 5 për qind kokainën dhe 5 për qind përzierjet e tjera. Ndërsa të gjithë i kanë provuar ndonjëherë përzierjet e ndryshme.

Mosha mesatare e pacientëve të varur nga droga është 24 vjeçare. Shumica prej tyre paraqiten pas katër-pesë vjet të konsumimit intensiv të drogës. Klinikën Neuropsikiatrike është e vetmja klinikë që merret me trajtimin e narkomanëve në Kosovë. ■

Jasir Krasniqi, hafizi më i ri i Republikës së Kosovës



Mbrëmja është shoqëruar me leximin e ajeteve Kur'anore prej hafizit më të ri në Kosovë, Jasir Krasniqi, e më pas është bërë edhe Duaja e Hafizit nga kryeimami i Tetovës, Hafiz efendi Ejupi, i cili edhe e ka bërë dorëzimin e diplomës në emër të Myftinisë së Tetovës.

Kreu i BIK-ut, mr. Naim Tërnavë, në fjalimin e tij përshëndetës, ka përgëzuar familjen Krasniqi, duke shtuar se me këtë po dëshmohej se Islami në trojet tona do të ruhet deri në kataklizëm. Ai ka premtuar se Bashkësia Islame e Kosovës së shpejti do të organizojë një tubim madhështor për diplomimin e hafizëve të rinj, dhe në emër të BIK-ut, të sapodiplomuarit ia ka dhënë një shpërblim prej 2 000 eurosh.

Në emër të familjes, të pranishmit i ka përshëndetur e falënderuar për pjesëmarrje, dr. Shefqet Krasniqi.

(Sadat Musa)

11-vjeçari Jasir (Shefqet) Krasniqi është hafizi më i ri në Kosovë. Ceremonia e ndarjes së diplomës, me rastin e përfundimit të nxënies përmendësh të Kur'anit, është organizuar në ambientet e Hotelit "Iliria" në Prishtinë, ku familja Krasniqi ka shtruar një iftar për më shumë se 130 mysafirë nga treva të ndryshme mbarëshqiptare.

Jasiri është i biri i dr. Shefqet Krasniqit, imam dhe ligjërues në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Nxënien përmendësh të Kur'anit e ka mësuar te Mahmud ef. Asllani në Tetovë.

Në ceremoni ishin të pranishëm edhe kryetari i BIK-ut, mr. Naim Tërnavë, kryeimami i Kosovës, Sabri Bajgora, ministri i Shëndetësisë, Alush Gashi, zëvendësministri i Shërbimeve Publike, Rifat Blaku, zyrtarë nga Partia e Drejtësisë, LDK-së, analisti dr. Milazim Krasniqi si dhe figura të tjera të shumta nga shoqëria civile.



Fotolajm



Pamje nga iftari i përbashkët me intelektualë, drejtues të institucioneve vendore e ndërkombëtare, përfaqësues të subjekteve politike, etj., të shtruar në hotelin "Grand" në Prishtinë nga Fondacioni për Arsim e Kulturë "Atmosfera"

Nga iftari i përbashkët për 50 studentë e studente të shtruar nga Organizata "Paqja studentore", në ambientet e motelit "Kalliri i mirësisë" në Prevallë (Prizren)



Bumerang

Mimoza SINANI

Ishite pranverë. Moti ndërronte vazhdimisht. Ndodhte një alternim i çuditshëm kohësh me diell e shi. Edlira ishte ulur pranë dritares dhe po shijonte ëmbëlsinë e trokitjes në xham të pikave të një shiu të butë e të ngrohtë pranveror që sapo kishte filluar të binte. Ajo e donte diellin, por e donte shumë edhe shiun. Shi u bënte melankolike dhe e fuste në meditime të thella. Gjithnjë kur binte shi preferonte të mbyllej dhe të strukej në cepin e dhomës së saj pranë dritares, xhamat e së cilës kërcisnin ëmbël nën melodinë harmonike të pikave të shiut. Rrëzatat e holla të shiut linin gjurmë vijash që dredhonin në hapësirën e xhamtë. Kohët e rënies së shiut ishin të vetmet kohë në të cilat ajo përqendrohej fort në thellësinë e vetvetes, meditonte për të shkuarën dhe ëndërronte për të ardhmen. Iu kujtuan turbull fragmente nga fëmijëria e saj. Mendimet iu kthjelluan kur solli në mend ditën e parë të shkollës.

Iu kujtua vetja: një vajzë e vogël me shikim të druajtur, me hapa të ngadaltë, me flokë të thurura gërshet të lidhura me kordele të kuqe. Por sot ajo nuk ishte më ajo vajza e habitur që priste me padurim të fillonte të lexonte dhe të mësonte. Vitet kishin rrjedhur dhe ajo ishte bërë një vajzë e pjekur gjimnaziste. Me kalimin e viteve, filizi i saj i njomë dhe delikat ishte forcuar për t'u bërë ballë me sukses rrebeshëve të kohës.

Shkolla i kishte dhënë ndjesinë e një limani të qetë në të cilin ajo kishte hedhur spirancën e anijes dhe ishte ankoruar në pjesën e parë të jetës së saj, për të mësuar, për t'u aftësuar dhe për t'u forcuar që më pas të çante me guxim në ujërat e thella të oqeanëve pafund, për t'u bërë ballë sfidave dhe për t'u ndier e sigurt nga tallazet e trazuara të jetës.

Me emocion kujtoi edhe ditën e parë të shkollës së mesme. Ndjeu një flad freskie dhe kujtimet i rrodhën nga shpirti tërë elektricitet. Ndjeu një ngazëllim që iu përzje me një kënaqësi të brendshme që s'dinte as vetë nga i vinte. Përpara syve i dolën shokët dhe shoqet e klasës: Njomza – me vështrim të butë si të një kumrie, e brishtë me tipare të ëmbla, me

një lëkurë me rrëzëllim alabastri, Vesa – një vajzë e hajthme me sy të kulluar, me qerpikë si krahë dallëndysheje, me lëkurë të bardhë qumësht si të zambakut me vesë, Diellza – një vajzë nazike, me sy të mrekullueshëm si bajame, me buzëqeshje të pafaj e gurgullues, me flokë të artë që i valëviteshin si krahë fluturë, Valmira – me sy të bukur, të mëdhenj, të kthjellët, të pastër e të sinqertë, e hajthme dhe e brishtë si një mështeknëz e hollë, Fatma me mbulesën e saj islame, me një bukuri që rrezatonte prej shpirtit të saj, me një paraqitje modeste e plot shije, e thjeshtë, krenare, me një buzëqeshje që buronte nga një lumturi e brendshme, me një personalitet dhe karakter të fortë, Dafina – me sy jeshilë, me qerpikë të dendur të zinj, me lëkurë të hollë e të lëmuar, Iliri – një djalë çapkën e gazmor, syzi me flokë gështenjë dallgë-dallgë, Shkëlqimi – me sy vetëtitës, me flokë të zinj të shndritshëm, Valdrini – me sy të kthjellët, me flokë të drejtë ngjyrë gështenjë të errët dhe me një tufë ballukesh të hijshme mbi ballë, Sokoli – me vështrim të thellë dhe qëndrim të matur, me libra gjatë gjithë kohës në duar.

Edlira ndjeu mall dhe dashuri për shokët e shoqet e veta. Ishin të gjithë të rinj, me mendime e zemra të pastra. Njohja e vetvetes dhe gjetja e identitetit ishin momente të rëndësishme në adoleshencën e tyre, një fazë që përcaktonte të ardhmen e tyre dhe zgjidhte enigmën se kush ishin ata në të vërtetë. Ishte një moshë kur ata vërenin, vlerësonin, reagonin, pohonin, mohonin, qortonin dhe mundoheshin të integroheshin duke dhënë mendimin dhe gjykimin e vet atyre.

Edlira hodhi vështrimin jashtë. Larg në horizont, një vazhdë resh të hirta në të bardhë qëndronin pezull. Disa dallëndyshe fluturuan para dritares si për të treguar me ecejaket e tyre se ishin kthyer nga shtegtimi i largët. Qielli ishte i tëri gri. Aty këtu re të murrme, që lëshonin tek tuk pikla të vogla e të rralla shiu, lëviznin ngadalë më nge, pa u shqetësuar nga muzgu i mbrëmjes që po afronte.

Edlira ndezi televizorin dhe u tultat në kolltuk.

Atmosfera e ndezur e zgjedhjeve elektorale të një muaji më parë ishte qetësuar. Stuhia propaganduese e krijuar nga klasa

mediatike ishte fashitur. Hapësira publike shqiptare kishte dëshmuar edhe njëherë shkretëtirën e pluhurosur të mendimit intelektual shqiptar, vetëdijen e mykur dhe zgjatimin e trishtë të mentalitetit të ngjizur në diktaturë. Klasa politike e dalë nga humbëtitat e servilizmit të sthurur partiak, me retorikën boshe dhe paturpësisht arrogante i kishte shfrytëzuar përsëri kompetencat hierarkike si mjet manipulimi gjatë gjithë asaj maskarade elektorale. Zinxhirët ngulfatës dhe prangat mbytëse të mentalitetit të ndryshkur të ngjizur në kornizat e ngurta të ideologjisë së dështuar totalitariste e kishin penguar edhe këtë herë politikën që të pastrohej nga fosilet e së kaluarës së dhimbshme. Dhe sigurisht, pas përpjekjeve sizifiane të të gjitha grupeve politike, pushtetin e kishin fituar ata që kishin pasur nivelin më të ulët të paskrupulltësisë.

E vetmja gjë e dukshme që kishte ndryshuar në qytetin e saj dhe e kishte mbushur hapësirën boshe të stuhisë propaganduese elektorale ishte emërimi i drejtorit të ri të gjimnazit, një militant i partisë që sapo kishte ardhur në pushtet.

E nesërmja u gdhi me diell. Edlira jetonte në një qytet shumë të bukur klimaterik që shtrihej buzë një liqeni të freskët dhe të kaltër. Disku i zjarrtë i diellit ndriçonte plot ëmbëlsi lart në kupën qiellore dhe shpërndante ngado rrezet e tij të ngrohta.

Edlira, si zakonisht, mori udhën për në shkollë. Hodhi shikim lart në qiellin e



hapur dhe pa se si lëvizte tërë ai qiell i lartë sipër kreshtave të maleve dhe e ndjeu veten shumë të vogël.

Nxënësit ecnin grupe-grupe në rrugët e qytetit të qeshur e të gëzuar si për të larguar monotoninë e ditëve të ftohta të dimrit. Rrugët e qytetit dukeshin si një lumë që rridhte vazhdimisht. Gjithçka gjallëronte dhe frymonte lirshëm. Pasi la bulevardin e rrugës kryesore u kthye majtas për të vazhduar rrugën që e çonte për në shkollë. Gjimnazi i qytetit gjendej jo më shumë se treqind metra larg liqenit kaltërosh. Në ajër ndihej aroma dehëse e luleve të blirit.

U ngjit në katin e tretë dhe hyri në klasë. Klasa ishte mbytur në dritë dielli pranveror. Nga dritarja qyteti dukej se lante sytë në ujërat e ndritshme pors argjend të liqenit të bukur. Nga lart vuri re degëza të bardha lule kumbullash që kishin buisur. Plepat degëgjërë kishin filluar të mugullonin dhe degëzat e njoma të përkulura të shelgjeve lotonjës ishin mbushur plot e përplot me gjethe të gjelbra. Në syprinën e liqenit përvijoheshin dridhjet e lehta të ngjyrave dhe

qetësia e tij thyhej nga klithmat e pulëbardhave që fshiknin ujën me krahët e tyre. Ai liqen i kaltër, i kthjellët, i shndritshëm kishte një bukuri mahnitëse që Edlirës i pikonte gjithmonë në shpirt teksa e vështronte dimër e verë. Edlira ishte lindur dhe rritur buzë atij liqeni të mrekullueshëm. Ishte endur këm-

bëzbathur mbi rërën e tij të lagur dhe kishte vërejtur e mahnitur se si i ndërronte ngjyrat sipas stinëve dhe kohëve të ditës: mëngjeseve nga i argjendtë bëhej i kaltër, ndërsa mbrëmjeve nga i përflakur bëhej i artë e i manushaqhtë, e pastaj kur egërsohej bëhej sterrë i zi. E kishte soditur edhe netëve kur hëna e bukur dhe e plotë dilte madhështore dhe me rrezet e saj i qëndiste ujërat e liqenit me shirita të argjendtë.

Klasa gumëzhinte nga zërat gazmorë të shokëve e shoqeve. Në derën e klasës u shfaq mësuesja dhe zërat u ndalën. Mësuesja e mbylli derën ngadalë, hodhi shikimin mbi fytyrat e nxënësve dhe me hap të ngadaltë u afrua te tavolina e vet. Klasën e pushtoi qetësia. Ajo hapi regjistrin dhe shënoi diçka shpejt e shpejt. U ul në heshtje në karrigen e vet dhe e humbi shikimin diku jashtë dritares. Pastaj me një zë ku ndihej një turbullim i përzier me keqardhje, lexoi vendimin e drejtorit të sapoemëruar për përjashtimin nga shkolla të Fatmës, për shkak të veshjes së saj islame, nën pretekstin se shkolla është laike. Edlirës menjëherë iu fanit përpara syve fytyra bizare e drejtorit dhe sytë e tij të vegjël me qerpikë të shkurtër si të çngjyrosur.

Fjalët e mësues u ngritën si re të zeza mbi kokat e nxënësve. Zëri i saj u përplas në mure dhe në klasë mbizotëroi një heshtje varri. Fytyrat e nxënësve u hutuan, u zverdhën dhe u ngurtësuan. Çdo gjë dukej se qëndronte pezull, fjalët ngrinë.

Edlirës iu duk sikur dielli u nda copë-copë dhe e ndjeu veten të zbrastët.

Xhami i kthjellët i dritares u mjegullua, ndërsa hapësira e kaltër e qiellit dukej si e fundosur në shkretëtirën e gjerë e të hapët të liqenit. Rrezet e diellit sikur donin të shkrinin ngurtësinë, ndërsa uji i turbullt i liqenit, që donte të kthjellej, vështronte me dëshpërim qiellin e kaltër.

Ka disa raste kur heshtja është mburoja më e mirë, por në disa raste brenda heshtjes rritet një shpërthim i ri, i fortë, i papritur.

Papritmas u dëgjua zëri kundërshtues i Sokolit, i cili shquhej për shkak të njohurive të gjithanshme dhe përgatitjes së tij të lartë. Ai u ngrit rrëmbimthi dhe duke mbajtur në dorë fletoren e tij të shënimeve tha:

- Mësuese! Në nenin 24 të Kushtetutës, në pikën e parë dhe të dytë, thuhet se "Liria e ndërgjegjes dhe e fesë

është e garantuar. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve". Edhe në nenin 18 të Konventës së Kombeve të Bashkuara, që konsiderohet si e shenjtë, thuhet se "Secili ka të drejtën e mendimit të lirë, vetëdijes dhe besimit, e kjo e drejtë nënkupton edhe lirinë e manifestimit, si individualisht ashtu edhe në bashkësi me të tjerët, të besimit apo mësimit fetar, kryerjen dhe mbajtjen e riteve fetare."

- Pra, ky nuk është laicitet, por është një diskriminim i fortë fetar – e përfundoi ai revoltën e vet.

Edlirës iu kujtua thënia e Solonit "Ligjet janë si puna e pezhishkave të merimangave, të dobëtit dhe të vegjlit ngecin në to, kurse të pasurit dhe të fuqishmit i bëjnë copa-copa." Vendimi dhe sjellja e paskrupullt e drejtorit i ngjalli ndjesinë e "argëtimit të egër subkoshient" si në lashtësi, në stadiumin e Koloseut Romak, për jetën dhe gjakun e gladiatorit, kërkesë kjo që përmbante tmerrin e gishtit të drejtuar poshtë.

Ajo ndjeu një valë nxehtësie t'i hipte në fytyrë. Një fërgëllimë i kaloi nëpër trup dhe brenda qenies së saj u formua një boshllëk. Ndjeu një shterpësi në shpirt dhe nuk po arrinte ta kuptonte atë që po ndodhte. Vetja dhe shokët e saj iu dukën si ca avuj të lehtë uji që vetëm po të bashkoheshin e po të ngriheshin lart mund të formonin një shi të furishëm dhe ashtu si shiu që e ndryshon, e transformon dhe e përtërit tokën e thatë e të plasaritur, edhe ata vetëm duke u bashkuar mund ta kundërshtonin, tronditnin dhe ndryshonin atë mentalitet të ndryshkur. Ndjenja të furishme uleshin dhe ngriheshin në zemrën e saj. Në gjakun e saj kish jetë, në jetën e saj kish shpresë, në shpresën e saj forcë e në forcën e saj dashuri. Ajo e donte shoqen e saj. U ngrit rrëmbimthi nga banka dhe tha me zë revoltues:

- Nëse Fatma përjashtohet nga shkolla, atëherë edhe unë do ta ndërpres mësimin në shenjë proteste.

Mendimin e saj e përkrahën të gjithë nxënësit.

Mësimi u ndërpre. Korridorët e shkollës buçitën nga hapat e zhurmshëm dhe zërat e lartë të tyre. ■

(vazhdon në numrin e ardhshëm)



Teksti i mallit

Vetmia me tekstin

Duke u rritur dhembja zgjatet edhe nata, andaj, si duket, P. Neruda këtu nuk ka forcë ta përballojë këtë, sepse ndihet i ligështuar para dashurisë së humbur.



Flamur MALOKU

Poeti i njohur kilian, Pablo Neruda, në poezinë “Kësaj nate mund të shkruaj vjersha të trishtme”, vë në dukje dashurinë personale të braktisur në kohë, braktisje e cila do të bëhet, tani në shkrim, rikthim për një lëndim shpirtëror. Kështu, në poezi do të vërehet se vetë trupi i kësaj bote është përherë i kalitur nga kujtimet e të së shkuarës. Koha e shkuar shpesh rikthehet në vetëdijen individuale, sidomos kur ajo ka të bëjë me prekje emocionale shpirtërore. Koha shëron plagë, po ajo nuk i shlyen kujtimet, qofshin ato të hidhura apo të lumtura. Jeta shkon, e kujtimet do të rikthehen varësisht moshës, vetë rikthimi nganjëherë bëhet pa dëshirën individuale për në kohën e shkuar, ku çdo rikthim për në të shkuarën, do të hapë plagën e kohës së tanishme subjektive. E tanishmja - koha, ndizet e rindizet në emocion dhe në gjendje, duke e rritur edhe më shumë dramaticitetin shpirtëror. Kjo do të thotë se tani edhe te subjekti nuk shëron plagë, e sidomos kur ka të bëjë me një lëndim shpirtëror subjektiv. Pra, një mos shërim i plagës shpirtërore do të artikulohej edhe në tekst, varësisht kërkimit të ndarjes nga të dy personat (ai dhe ajo). Plaga shpirtërore përballë dashurisë së humbur sa vjen e shtohet, nëse ka qenë fjala për një dashuri të sinqertë, por që në poezinë “Kësaj nate mund të shkruaj vjersha të trishtme”, do të tregohet një mos identifikim i njëshit shpirtëror përballë dashurisë. Ky mos identifikim i njëshit shpirtëror rezulton me ndarje, e cila tani vetëm kujtohet mbi mosrealizimin - finalizimin e kësaj dashurie jetësore. Kjo humbje e dashurisë për diskursin e tekstit bëhet shumë motivuese për një thurje të tekstit. Kështu, pra mosrealizimi i saj në jetë, tani bëhet motivim, motivim i cili, padyshim, do të bëhet pikë dëshpërimit po edhe pikë referimi për subjektin lirik në jetë. Kjo dashuri do të kujtohet përherë me nota të mëdha mallëngjimi, meqë përbrenda subjektit ajo ka mbetur dhembje shpirtërore, duke mos e lënë anash as fajësimin e tij karshi asaj. Fajësimi subjektiv është edhe shtytje për në vetë kujtimin, duke e kujtuar, thur diskursin elegjiak për të, duke e kanalizuar kështu, para së gjithash, edhe vetë ligjërimin e tekstit, për të shprehur çdoherë idenë e mosrealizimit të kësaj dashurie. Kështu, malli autorial shtrihet në vetmi, e vetmia e shprehur në kohën e tanishme do ta sjellë gjendjen e prekshme emocionale, e cila do të hapet fuqishëm në strukturën e poezisë, me një ngjyrim të fortë emocional. Subjekti e hap poezinë në natën e vonë. Nata është kohë qetësie, kohë monotonie, që tani do të bëhet edhe kohë trishtimi për autorin, sepse po kujtohet ndarja nga personi i dashur; në esencë vetë ndarja është trishtuese, andaj edhe nata i përshtatet këtij trishtimi.

*Kësaj nate mund të shkruaj vjersha të trishtme.
Të shkruaj, për shembull: “Në këtë natë të kthjellët
rrëqethen ndër ethe yjet e largëta të kaltër”.*

*Në qiej era e natës vrapon e këndon.
Kësaj nate mund të shkruaj vjersha tmerrisht të trishtme,
Kaq herë e pata puthur nën qiellin e hapur!*

Tani autori shpalos vetveten para kësaj dashurie të humbur, duke e shënjuar çdoherë dhembjen mbi mungesën e personit të dashur. Mungesa e asaj vërehet në hapje të vetvetes. Hapja e vetvetes karshi përshkrimit që i bën subjekti asaj vetëm sa e rëndon shpirtërisht dhe emocionalisht. Duke u hapur subjekti në tekst, hapet edhe shpirtërorja e gjendjes momentale. Gjendjen momentale shpirtërore e bën më të papërballueshme kur përshkruhet bukuria e saj, e sidomos kur shënjohej edhe fajësimi personal në mos dashurinë e sinqertë ndaj asaj:

*Ajo më deshti edhe unë kohë pas kohe e pata dashur.
E si mos i desha ata sy kaq të mëdhenj?
Kësaj nate mund të shkruaj vjersha tmerrisht të
trishtme,
Kur mendoj se e nuk e kam pranë. Kur ndjej se e humba.
Po të kjo natë e gjatë më duket akoma më gjatë.
Dhe vesa e livadheve pikon në shpirtin e vjershave.*

E gjithë kjo ta jep idenë e subjektit të emocionalizuar, e të rikthyer në mallëngjim shpirtëror, kur ndihet së është humbur dashuria, kur humbja e asaj është edhe nga fajësimi subjektiv.

PABLO NERUDA





Malli i gjatë

Nata bëhet e gjatë dhe e vetmuar. Kjo gjatësi e natës, si duket, është pambarim për autorin. **“Pa të kjo natë e gjatë më duket akoma më e gjatë”**, kjo do të thotë se nuk është personi i dashur afër, mospranim - mungesa bëhet edhe më e madhe në zgjatje të vet dhembjes shpirtërore. Nata është e gjatë, sepse dhembja në vetë përkujtimin e saj është i gjatë. Duke u rritur dhembja zgjatet edhe nata, andaj, si duket, P. Neruda këtu nuk ka forcë ta përballojë këtë, sepse ndihet i ligështuar para dashurisë së humbur. Mirëpo këtë ligështim subjekti mundohet që ta rikthejë prapë në forcë dhe në arsyetim në vargjet e mëposhtme:

**Po s’kam ç’bëj: me dashurinë time s’e ndala dot.
Yjet si prush xixëllojnë - po ajo s’është me mua.**

Arsyetimi subjektiv është vetëm nga shkakut i mospërballimit të dhembjes, ku edhe përdorimi i figurës si yjet, s’është gjë tjetër pos një përpjekje e butësisë trupore- shpirtërore. Pra, shkurt, sikur dëshiron që ta mbulojë fajin mbi dashurinë e fajësuar dhe të parealizuar nga vetë ky. Pra, shihet dhe preket ajo që është gjendje pikëllimi në përshkrim të unit subjektiv, çdoherë me një arsyetim të dashurisë ndaj asaj siç vërehet:

**Kaq. Një zë këndon matanë, përtej... Larg.
Po shpirti im vuan se atë e humba.
Kërkoj vështrimin e saj, sikur dua t’i afrohem.
Zemra ime e do - po ajo s’është me mua
Natë si dikur: zbardhojnë, të njëjtat pemë
Ne ishim dikur bashkë, por tani s’jemi si dikur.**

Vazhdimisht në vargje kërkohet prania e asaj, edhe më shumë natën kur ky ndihet i vetmuar. Vetmia bëhet dyfishë - brendore, nga kujtimi i kohës së bashkuar, dyfishimi i të shkuarës shoqërohet me pikëllim, ndërsa e tashmja shoqëro-

het me vuajtje dhe fajësim, njëkohësisht edhe pa ngushëllim. E tashmja bëhet edhe më e rëndë, sepse preket - njihet fajësimi, e sidomos kur ky e di se ajo tani është me tjerë:

**Me të tjerë ka shkuar. Po, me të tjerë
Por dikur ishte vetëm
Imja pat qenë
Sepse në një natë të tillë e pata përqaftuar
Dhe shpirti im vuan, atë e humba**

E tashmja - personalja përjetohet shumë më rëndë, sepse ajo dikur ka qenë e tij, dhe tash nuk është. Shkurt, të dy kohët në diskursin e poezisë dhe në strukturën shënjuese artikulojnë gjendje shqetësuese, sepse tani ky e ka larg atë. Largësia është, para së gjithash, edhe shënjuese e gjendjes shqetësuese, sidomos kur nata e tashme si kohë e dërgon tek i njëjti kujtim subjektiv. Kujtimi bëhet vetmi përballë gjuhës së tekstit. Kjo natë subjektivin e bën të thurë vargje, ndoshta edhe vargjet e fundit për të dhe për vetë dhembjen që ka për të:

**Të paktën kjo lë të jetë dhembja e fundit që sjell ajo,
Dhe këta rreshtat e fundit që për të po i shkruaj.**

Kështu e përfundon subjekti lirik poezinë, duke përfunduar edhe vargjet së shkruari për të, duke e flakur edhe dhembjen që ajo i ka sjellë në jetë, por jo se Neruda s’do të shkruajë edhe më vonë. Një natë e tillë me yje do të ndodhë prapëseprapë në jetë, dhe shumë herë do të bëhet rikthim për kujtimin e asaj, e cila do të shënjojë dhembjen shpirtërore gjatë tërë jetës, sepse siç thotë Ibrahim Rugova “Ndarja e fundme ka dhembjen e vet, që të ndjek edhe të përvëlton në shpirt dhe në kujtime”. Prandaj, poezia e Nerudes “Kësaj nate mund të shkruaj vjersha të trishtme” të bënë të vuash, duke të krijuar idenë e vetmisë me tekstin gjatë leximit e rileximit, vetmi kjo që vazhdon edhe sot. ■

Poezi

Në pikë të verës bora

Sali BASHOTA



Gjurmë

Prapë po të lë të buzëqeshur
Më flakën e kuqe ndër duar

Këmbëkryq do të ulësh një ditë
Pas kaq vjetësh vetmie

Përtej gjurmës që nuk shihet
Koha ime plot shqetësime

Prapë çuditërisht po të flas
Matanë bregut ëndërrimtar

Guri i dashurisë

Sa pak të paskam harruar
Sa shumë të paskam gdhendur
Guri im

Tash ç't'i them nënës
Kur sytë s'më bëjnë dritë
Guri im

Mbi bjeshkët e Kosovës
Në pikë të verës bora
Plis i bardhë

Sa shumë të paskam gdhendur
Pa të harruar
Guri im i vdekjes

Pikëllim

Stinët e dashurisë vdesin
Pa ma vrarë shpirtin
Vetëm Drita qan në dritare

Pas urrejtjes

Ti qan për lulen e zezë
Që mbën në kopshtin e mortit
Farë e keqe e tokës

Ti vërtet qan

Ti klith për lirikën e vrarë
Me dorën e zezë të mashtrimit
Fjalë e kafshuar e çmendisë

Ti vërtet klith

Ti mallkon stinën e djegur
Me zjarrin kryeneç të verbimit
Shkrumb gjuhën e bën

Ti vërtet mallkon

Ti qan
Klith
mallkon

Rea apo një ëndërr tjetër

Po të mos ishte Ajo
Dashuria do të kishte emër tjetër

Prandaj
T'i dua sytë e tu të kaltër

Po të mos ishte Ajo
Zogjtë nuk do të fluturonin në qiell

Prandaj
T'i dua sytë e tu të kaltër

Po të mos ishte Ajo
Dhembja do të bëhej kukamë

Prandaj
T'i dua sytë e tu të kaltër

Vështrim për dramën

P(r)oetika dramatike



Berat DAKAJ

Origjina e dramës është shumë e hershme. Rrënjët e saj në antikitet, por kuptimi për kufijtë e sotëm të saj është shumë afër atij që ka dhënë Aristoteli për tragjedinë (gjatë kohës sa mendohet se jetoi, 384-322 p.e.s) te *Poetika*, në të cilën konstatoi se *tragjedia është imitim i një veprimi të rëndësishëm e të përkryer, që ka një madhësi të caktuar, të dhënë me anë të një së folure të ëmbël e të përshtatur me çdo pjesë veç, veprim që shfaqet me anë personash, të cilët veprojnë e nuk recitojnë dhe që kryen pastrimin e pasioneve me anë të mëshirës e të frikës* (duke përfshirë këtu nocionin e mëvonshëm për dramaturgjinë: gjininë e dramës, tragjedisë, komedisë, tragjikomedisë (zhanreve të sotme të saj) etj).

Pas një periudhe të mëvonshme e të hovshme të zhvillimit të dramës, Hegeli u përpoq që asaj t'ia krijonte dy kufij. *Drama për nga struktura përmbajtjesore qëndron mes tragjedisë dhe komedisë sepse në të kufiri ndërmjet tragjikes dhe komikes synohet të shkrihet, apo që të dy këto komponente, duke mos e përjashtuar njëra-tjetrën, aplikohen duke e formësuar një tërësi konkrete.*

Mirëpo drama (greq: *gjenitivi – ramatos veprim*), kjo gjini e dhembshme (dramatike) e qesharake (komike) e letërsisë, që bart e imiton veprime nga jeta e përditshme, nëpërmjet personazheve (dialogëve e monologëve të tyre), ngërthehen kuptimet për veprën letrare e cila i dedikohet shfaqjes në skenë, në teatër me artistë dhe në praninë e publi-

kut. Kështu që, ajo ka një specifikë tjetër nga letërsia artistike. Detyra themelore e saj (dramaturgjisë), shkruan Sergej Baluhati, në një studim për problemet e analizës së dramës, *nuk është teoria, por kritika e dramës, e verifikuar me materialet e ndryshme, prandaj dramaturgjia, përkatësisht poetika e dramës mund të krijohet në dy mënyra: qoftë me krijimin e “teorisë” e cila e përfshin plotësisht “natyrën” e artit dramatik, “ligjet e krijimit të dramës, tipat dhe rastet e formës “të pastër” ose të formës së çrregulluar dramatike, qoftë me zbatimin e metodës krahasimtare – analitike, që domethënë nëpërmjet përshkrimit të procedurave të veçanta dhe të përgjithshme të shkrimit të dramës, veprimeve të përpunimit letrar – skenik të materialit dramatik, të karaktereve dramatike dhe të situatave; nëpërmjet numërimit të një vargu faktorësh të cilët e përcaktojnë stilin e lojës interferente; nëpërmjet përcaktimit të veçorive themelore të formës dramatike edhe të funksioneve të saja.*

Varësisht këtyre, kuptojmë që drama ka edhe rrugë të tjera që kalojnë nëpër këta kufij të saj, që përmend Baluhati. Për të është shumë specifike gjuha që përdor. Gjuha e prozës (romanit, novelës, tregimit etj.) është metaforike, që dramës fatmirësisht nuk i duhet. Tragjedia, sipas Aristotelit, është veprim që shfaqet me anë personash, të cilët veprojnë e nuk recitojnë. Megjithëqë Aristoteli e rrudh pak poetikën e tragjedisë, duke e përcaktuar atë veprim e jo gjuhë, ka tendenca që ajo të kuptohet vetëm si lëvizje/veprim! Por, me këtë interpretim fillestar të tij, kuptojmë që ne nuk duhet ta bëjmë personazhin e dramës rrëfyes për veprimet e veta. Pra, do të ishte shumë e paarsyeshme nëse i themi atij (personazhit) të tregojë për sjelljet e veta që do t'i bëjë në teatër,

pra sikur dramaturgu t'i thotë që ai të thotë se: tash po shkoj deri te tavolina dhe po e marr thikën, kur ne e shohim se ai tashmë është nisur drejt tavolinës dhe ka kapur thikën. Pra, kuptojmë që, gjuha e dramës duhet të jetë dramatike, të përdoret vetëm në momentin kur fjala s'mund ta zëvendësojë lëvizjen e aktorit. Aktori i teatrit (pra personazhi i veprave dramatike) natyrisht që duhet të flasë dhe të bëjë gjeste/veprime, të cilat më së miri e arsyetojnë karakterin e dramës, mirëpo ai duhet të jetë në gjendje që edhe me gjuhë edhe me gjeste të sjellë kënaqësi, tmerr, mëshirë për publikun.

Baluhati këtij konteksti të dramës i shton se, *krahas ngjyrimin të vet gjuhësor ekspresiv që krijohet nga dëshira që “emocionet” e personazheve të shprehen me fjalët të cilat i thonë ato, e folmja dramatike bëhet e ndërlikuar edhe për arsye se gjithnjë duhet të jetë autokarakteristike për personin e caktuar në çmënyrë kompensohet gati mungesa e plotë e elementeve të narracionit ose të rrëfimit në dramë. Prandaj, shkruan Baluhati, materiali gjuhësor dramatik nuk i shërben vetëm shenjave tematike, por edhe shenjave të veta të mimikrisë dhe shenjave gjestuale, që ngërthehen në fjalën e thënë dhe të plotësuar me shënime përkatëse të autorit.*

Së këndejmi, ky kontekst shpjegues i jep funksion të rëndësishëm gjuhës, fjalës dramatike (e kushtëzuar nga parimet stilistike), e cila nëpërmjet dinamizmit të vet sjell emocione.

Me këtë rast duhen përmendur edhe faktorët që e organizojnë sistemin gjuhësor të dramës: atë tematik (i cili bart idetë e personazheve, gjuhën karakterizuese të tyre) dhe emocional (që fut në funksion sjelljet e personazheve/aktorëve). ■

Mbresë

Dimensione të reja teatrore

Shfaqje e mirë për t'i rezistuar kohës, dhe për të mbetur monument në historinë teatrore



Naser SHATROLI

Në Teatrin Dodona, këto ditë ndodhi një befasi e papritur një eveniment teatror. Në vazhdim të premierave, këto ditë sezonin e mbylli një shfaqje e njohur 'Tregimi zoo' një fenomen i rrallë teatror që kapërcen çdo kufi të mundshëm artistik me regji të Sokol Plakollit, dhe me dy margaritarët e skenës Ismet Azemi dhe Mentor Zymberaj, që nuk kemi pasur rast t'i shohim për një kohë të gjatë, mbase të gjatë me vite do të thosha në këtë teatër. Çdo gjë në këtë shfaqje ishte brilante, me një skenografi të Mentor Berishës, ideale me elemente horrori e përpunuar deri në finesa, e me veshje efikase, model për karakteret dhe me një muzikë me efekte origjinale të gërshetuar ngushtë me shfaqjen në tërësi. Të gjitha këto janë elemente që e përbëjnë një shfaqje të mirë për t'i rezistuar kohës, dhe për të mbetur monument në historinë teatrore. Kjo trio e shkëlqyer insiston që t'ia kthejë besimin e humbur artistit, teatrit, artit në përgjithësi dhe, pa dyshim, nga kjo

natë do të hapen horizonte të reja për skenën shqiptare dhe vizionin e saj.

Një kuptim i mundshëm

Lufta për pushtet, për herë të parë regjisori e shfrytëzon një dramë botërore të një mentaliteti të dikurshëm amerikan, dhe e zbarkon atë si ide në rrethana vendore në mentalitetin shqiptar, e ambienton atë në një shpellë të kamufluar me rretetë merimange, ku brenda saj janë gjurmët e eshtrave të humbur, të harruar prej kohës. Buzë saj është edhe një kasolle, të cilën e ka mbuluar myku kohor, që shërben si shtëpi banuese, botuese, politike, e cila për themele ka këmbët, shputat e dinozaurëve, çmenduri ideore mund të thuhej. Perdja hapet me shkrimtarin, të cilin nuk do ta lejojnë për të fjetur në bankën e tij, britmat e insekteve dhe kafshëve, sikur e lajmërojnë atë se do t'i vijë vrasësi i tyre. Ai i ruan me fanatizëm, si të thuash në koleksionin e tij nga një asht të secilës kafshë, me nga një shirit të kuq, në shenjë dëshmie dhe përkujtimi njëkohësisht, dhe krejt në fund do të zbulohet edhe qeni i tij i vrarë, besniku rojtari i lapsit i bankës i fronit të tij. Me aq mund, siç thotë ai rreth 30 vite radhazi, kur mbushet kupa, si thuhet,

atëherë vjen shpërthimi katarsisi i saj, për t'ia ndërruar kahun rrjedhave të historisë, dhe do të vijmë tek momenti, kush është kafsha e vërtetë. Kjo do të vërtetohet tek vrasja, Jerry, do ta kërkojë atë, vdekjen, që nga lindja në perëndim dhe që nga jugu në veri. Mirëpo ky nuk mund ta vrasë vetveten. Ai dëshiron që vdekjes së tij t'i rritet vlera dhe nami në histori dhe e përdor mjeshtrin e tij, thikën, të cilën ja jep me dhunë Piterit dhe dhunshëm me dorën e autorit të tij do ta vrasë veten për të ndërruar jetë në bankë. Kjo del si gjeturi, si mjeshtri e pakapërcyeshme dramaturgjike, se e keqja nuk vdes, pa lënë varrë në kohë, ajo do të mbetet në dorën e autorit, pra endacaku do ta përlyejë pastërtinë e shkrimtarit të tij me gjak të prishur. E gjithë kjo ngjarje dramaturgjike, me një regjisor të talentuar, siç është Sokol Plakolli dhe me aktorë të shkëlqyer, siç janë Ismet Azemi dhe Mentor Zymberaj, do të mbetet kujtesë për kohën, duke shënuar një mesazh të fuqishëm, mbi vetë enigmën e kohës, për të mbetur pastaj ide dhe koncept i një bote konotative. Andaj, kjo shfaqje hap dimensione të reja teatrore në skenën shqiptare, që nuk guxonte të reagoje, që edhe kur duhej qeshur apo qarë, edhe kur duhej duartrokita, mbetej e heshtur. ■



Kontracesioni emergjent (KE)

Kontracesioni emergjent është një metodë e sigurt dhe e besueshme për të parandaluar shtatzënesinë e padëshiruar pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtura. Po ashtu është e vetmja mënyrë për të parandaluar shtatzënesinë pasi femra të jetë dhunuar.

Iliriana ALLOQI & Bernard TAHIRBEGOLLI

Si funksionojnë KE-të?

Ka ndodhur ndonjëherë të keni pasur marrëdhënie seksuale por:

- Nuk keni përdorur asnjë kontraktiv,

- Kondomi ka rrëshqitur apo është dëmtuar

- Bashkëshorti juaj nuk është tërhequr me kohë,

- Keni harruar të përdorni më shumë se dy pílula kontraktive të rregullta,

- Jeni vonuar më shumë se një javë për të marrë injeksionin me kontraktiv,

- Keni pësuar marrëdhënie seksuale pa dëshirën tuaj (dhunim) dhe dyshoni se mund të mbeteni shtatzënë.

Pa dyshim këto janë rastet më potenciale që ju të filloni një shtatzëni të padëshirueshme. Si të veproni në këto situata? Ku të drejtoheni? A keni menduar që mund të ketë një plan rezervë për ju edhe në këtë gjendje?

Nëse keni menduar e përgjigjen nuk e keni gjetur akoma, atëherë përgjigja është PO. Ai është: kontracesioni emergjent - KE.

Çka është Kontracesioni Emergjent (KE)?

KE – Kontracesioni Emergjent (pílula e kontracesionit emergjent) është një dozë speciale e hormoneve që parandalon shtatzënesinë pasi të keni pasur marrëdhënie seksuale të pambrojtura. Disa njerëz e quajnë “pílulat në mëngjes pas marrëdhënieve seksuale” por në fakt ka kohë të përdoren deri në 3 ditë (72 orë) pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtura.

Pílulat e kontracesionit emergjent funksionojnë sikurse edhe pílulat e tjera kundër shtatzënesisë, vetëm se këto kanë një dozë më të madhe hormoneve dhe përdoren pas marrëdhënieve seksuale. Pílulat e KE-së nuk janë pílula për të shkaktuar abort.

Si të sigurohen KE-të?

Është me rëndësi të merrni KE-të sa më parë që të jetë e mundur, pasi të keni pasur marrëdhënie seksuale të pambrojtura. Disa mënyra se si mund ta merrni:

- Kontakto mjekun apo infermieren tuaj,

- Shkoni në

Vërejtje:
Pílulat e rregullta nuk janë kontracesion emergjent.

Këshillë:
Nëse villni brenda 2 orësh pasi të keni marrë kontraktivet emergjentë duhet të përsëritet doza.


qendrat shëndetësore (Qendrat e Mjekësisë Familjare), nuk keni nevojë të caktoni terminin e vizitës.

- U thuaj atyre në që keni nevojë për kontracesion emergjent,

- Nuk keni nevojë për ekzaminime fizike për të marrë KE-të!

Si të përdoren KE-të?

Shumica e institucioneve shëndetësore dhe farmacive kanë dy lloje të KE-ve, pílulat vetëm me progestin dhe ato të kombinuara



me estrogjene dhe progesteron. Të dyja llojet kanë nga dy doza.

Doza e parë merret brenda 3 ditëve pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtura (sa më parë aq më mirë), ndërsa doza e dytë saktësisht 12 orë pas dozës së parë. Nëse nuk vijjnë menstruacionet brenda 3 javësh, apo menstruacionet janë shumë të lehta, kontaktoni mjekun apo infermierin.

Përparësitë e përdorimit me kohë të KE-së

KE-ja i ofron gruas një plan të besueshëm dhe rezervë për parandalimin e shtatzënisë së padëshiruar. Disa nga arsyet pse femrat zgjedhin të përdorin KE-të:

- ◆ Mund të parandalojnë shtatzëninë deri në 3 ditë (72 orë) pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtura,
- ◆ Nuk kanë efekte anësore afatgjate,
- ◆ Janë të sigurta për të gjitha femrat, madje edhe ato që nuk mund të përdorin estrogjene,
- ◆ Mund të mbahen afër vetes (të ruhen),
- ◆ Efikasiteti 75- 85 %.

Çka duhet të dini?

KE-ja ka shumë pak mangësi! Por është me rëndësi të dini se:

- ◆ KE-ja është më pak efektiv se sa marrja e pilulave të rregullta, Depo ose kondomat,
- ◆ Nëse KE-ja nuk ka funksionuar dhe ju mbeten shtatzënë, ekziston një rrezik se do të mbeten shtatzënë jashtë mitrës,

FAKT:
Çdo femër duhet të dijë për KE.

FAKT:
KE është më së shumti efektiv nëse e merrni brenda 24 orëve pas kontaktit seksual të pambrojtur.

◆ KE-të nuk ju mbrojnë nga HIV-i apo infeksionet tjera me bartje seksuale.

Efektet më të shpeshta anësore

KE-ja është shumë e sigurt. Efekti më i shpeshtë anësor është nauzea (ndjenja e vjelljes), por ky efekt zgjatë vetëm një ditë. Disa efekte të përkohshme anësore janë edhe:

- ◆ Zbutja e gjinjve,
- ◆ Ndryshimi i periudhave të menstruacioneve,
- ◆ Menstruacioni i ardhshëm mund të jetë me gjakderdhje më të mëdha apo më të vogla.

Tregoju shoqeve

KE-ja është i sigurt dhe një metodë e besueshme për të parandaluar shtatzëninë e padëshiruar pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtura. Po ashtu është e vetmja mënyrë për të parandaluar shtatzëninë pasi femra të jetë dhunuar. Por shumë femra ende nuk dinë për KE-të. Kështu, shpërndaje fjalën dhe tregoju edhe shoqeve të tua.

Pyetjet më të shpeshta rreth KE-së

Sa herë mund të përdor KE-të?

Ju mund të përdorni KE-të sa herë që keni nevojë. Do të jetë njëjtë efektiv pavarësisht sa herë përdoret.



Por KE-ja nuk është metodë e rregullt për të parandaluar shtatzëninë. Nëse vëreni se keni nevojë të përdorni shumë shpesh KE-të, atëherë është mirë të flisni me infermierin apo mjekun tuaj dhe së bashku me ta ju do të zgjidhni një metodë kundër shtatzënisë që është më e mira për ju.

Kur mund të filloj të përdor metoda të rregullta kundër shtatzënisë?

Menjëherë! Ju mund të filloni të përdorni metoda të rregullta si Kondomat apo Depo që nga dita që

apokë nga dita që keni përdorur KE-të. Metodat e tjera siç janë pilulat mund të fillohen nga dita e nesërme.

Nëse KE –të nuk funksionojnë dhe unë mbetem shtatzënë, a do të lëndohet fryti?

Jo. Nuk ka asnjë dëshmi mjekësore që thotë se kjo mund të dëmtoj frytin. KE –të nuk janë pilula për të shkaktuar abort. Nuk ndalojnë shtatzëninë nëse veç ka filluar.

A ka ndonjë mënyrë për të ruajtur në shtëpi KE –të në rast se më nevojitet?

Po! Çdo femër mund ta ketë në shtëpi, si plan rezervë nëse i nevojitet.

Ju mund të kërkoni nga institucionet shëndetësore apo farmacia për të marrë një paketim me vete në shtëpi. ■

Vërejtje:
KE-në përdorni sa herë të keni nevojë, por mos e praktikoni si formë të rregullt kontracepsioni.

Këshilla praktike

• Që peshqit të mos ju thërrmohen gjatë skuqjes, kripini, lyejini me lëng limoni dhe lërinini në kullësë rreth gjysmë ore. Më pas, skuqini në vaj jo shumë të nxehtë.



• Në mënyrë që të heqësh erën e peshkut nga duart, pastroji ato duke i fërkuar mirë me limon.



• Mund të zhdokësh erën e qepës apo të hudhrave duke i fërkuar duart me uthull të bardhë, menjëherë pas mbarimit të përgatitjes së ushqimit.



• Perimet ruhen mirë për disa ditë nëse mbështillen me një pecetë të lagur.

• Vitaminat që ndodhen në perimet e freskëta janë shumë të ndjeshme gjatë përpunimit të nxehtë, prandaj është më mirë që ato të zihen shpejt e në zjarr të fortë.



• Patatet e ziera qërohen më lehtë nëse pas zierjes hidhen në ujë të ftohtë.

• Që panxhari i kuq të ruajë ngjyrën gjatë zierjes, në vend të kripës në ujë hidhet pak uthull.



• Mbas qërimin të patateve, karotave, e perimeve të tjera, duarve ju hiqen njollat nëse lahen me lëng limoni.

• Kur gjiza është e thartë përzihet me qumësht në raportin 1:1, pasi lihet një orë kullohet, kështu që gjiza bëhet e ëmbël dhe e freskët.



• Djathi shumë i kripur njomet me ujë të zier, por të ftohur.

• Djathi i tharë që të bëhet i butë vihet për pak kohë në qumësht.

• Kur rrihen të bardhat e vezëve që t'u shtohen më shumë vëllimi për çdo kokërr vezë i shtohet një gjysmë luge gjelle ujë.



• Për ta ruajtur bukën të freskët, mbajeni në ngrirje të frigoriferit. Kur ta nxirrni, do të shikoni se ka mbetur e freskët, sikur ta keni blerë atë ditë.



• Që të mos ju forcohen bërçollat gjatë skuqjes, veproni në këtë mënyrë: grini në rende një qepë të madhe dhe para se t'i skuqni bërçollat, mbulojeni sipërfaqen e tyre me këtë shtresë qepe të grirë. Lërinini për 2-3 orë. Në vazhdim, skuqini. Rezultati do t'ju lërë gojëhapur!



• Që të shmangni lotët gjatë pastrimit të qepëve, mund t'i lini ato të ndara në ngrirje të frigoriferit ose në ujë të ftohtë. Më pas pastrojini.



• Që ta ruani gjalpin sa më të freskët, hidhni brenda tij një copë karotë të pastruar.



• Nëse doni ta mbani kafënë të freskët dhe me aromë, atëherë mund ta ruani në frigorifer.



• Perimet e vyshkura gjallërohen, nëse i vendosni për disa orë në frigorifer të mbuluara me pecetë të lagur.



















• Mund t'i ruani limonët të freskët, nëse i vendosni në frigorifer në një vazo me ujë të mbyllur me kapak.



• Që të kuptoni nëse fasulet janë bajate, bëni këtë provë: kafshojini dhe shikoni nëse mbetet në to shenja e dhëmbëve. Nëse nuk mbetet shenjë, atëherë fasulet janë bajate.

• Që orizi të mos ngjitet gjatë zierjes, hidhni në tenxhere pak lëng limoni.

Përgatiti: Ditë Lind Reshiti

AUTOR: ENDRITI	BANOR I NJË QYTETI TONË	ËNDJE PËR TË NGRËNË	VEGËL MUZIKORE (SHQ.)	PËREMËR VETOR	USHQEVA BEBEN	ZANORE	OBJEKTI I BISEDËS	EVDION (PERKDH.)	MJET UDHËTIMI (SHQ.)		ZANORE	BANORI I NJË SHTETI AFRIKAN		FUTBOLLISTI SENEGALEZ HENRI (WEST HAM) DEM, BIK
KUNDËRTHËNIE A KUNDËRSHTIM I PLOTË (FIG)										SHKENCËTARI NJËTON LLOJ PAPANALLI				
						FUTBOLLISTI I MANCHESTER UNITED PATRICE I SISTEMATIZUAR					AKTORJA E FAMSHME TURMAN ATEMOR, JO TEMATIK			
KËNGËTARJA BUNJAKU RILINDËSI YNË NË FOTO														SFOND SHKRONJASH
"K" NË MES TË DY "A"				REGJISORI QOSJA QË I PERKET NJË KOHE TË LASHTË, SHUMË I VJETËR				MENDJELEHTI AKTORJA E VJETËR AMERIKANE MERIL						
NIOR SAVIOTA			BABAI AMERICAN ACADEMY OF RELIGION				ALARM, ZILE (SH.SHQ.) ELECTRO-OPTICS TECHNOLOGY							
	KAPITULL I FUNDIT I NJË ROMANI	BANORE E HERSHËM E NJË KRAHINE (SH.SHQ.) SABOTAZH							"AMERICA" IVOA				ZANORE SHTETI I PARAARDHËS-VE TANE	
PIKTORI YNË VALLA						AKTORJA HOLLIVUDIANE SPELLING RAST, MUNDËSI				STREHIM POLITIK EMBLEMA				
VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT									MËNYRË E TË SHKRUARIT (SHQ.) MODERATORI KRASTA					
IDRIZ BALAJ			ZOTËROJ DIÇKA PUSËLLAT				PËRFUNDIM NË SHAH (SHQ.) I EMËROVE						ILAZ KODRA NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE	
LËNG SYRI				ISH FUTBOLLISTI PORTUGEZ MANUEL ... COSTA TOKIO				TËRËSI E ORENDIVE KNOWLEDGE MASTER OPEN						KËSHILLI NACIONAL
PEZMATIM I VESHIT						ANKESË FUTBOLLIST SHQUAR BRAZILIAN (MILAN)							SHOK SHKRONJA E 24-TË	
GIKORA (SHK.)				METAL ME SHKELQIM SI ARGJEND (CR) NJËSIA PËR MATJEN E FLORIRIT					KËNGËTARI KËRILIU KËNGËTARJA BRITANIKE TIKARAM					
	QYTET I SHENJTË I MUSLIMANËVE QË VEPRON ME GJALLËRI						KOHË SUEEDIA							
ZANORE		VOZITJE ME PAGESË HAPËSIRË E MADHE UJI (SHQ.)						ZANORE GRUP NJËRËZISH TË LIDHUR NGA INTERESA VETJAKE TË NJËJTA						
SUPER MODELJA & KËNGËTARJA ITALIANE BRUNI							"K" NË MES TË DY "N" GRENLANDA, ESTONIA							
FRIKA						SHËNIM NË FUTBOLL (SHQ.) RESHAT ARBANA								
INVA MULA			KRAHINË E GJERË (SH.SHQ.) BASHKËT-INGËLLORE											
QYTET NË KOSOVË							PJATA							

